



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e LVI-të (pesëdhjetegjashtë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 30 korrik 2025.

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; Donjetë Baliu, ndërsa mungoi Florent Hasani;

Nga LDK Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Qëndresë Haliti; Fatmir Gashi; kurse munguan Valon Demolli; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani;

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu, Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli, kurse mungoi Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkrjetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.)

Të pranishëm ishin edhe Samir Calakovic përfaqësues i OSBE, përfaqësues të KFOR - LMT, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, theksoi, për momentin konstatojmë se janë 21 anëtarë/e të Kuvendit kurse mungojnë 14 që do të thotë se ka mungesa të shumta në këtë fillim mbledhje, të presim që do të vijnë edhe të tjerë por mendoj se është mirë që në fund të mbledhjes t'jua lexojmë emrat të gjithë atyre që nuk vijnë në mbledhje.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës së bashku me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 21 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent për momentin në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së ku ndër të tjera përfshihet edhe pika shtesë (5.4) në kuadër të pikës 5 të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të prezantuar në KPF dhe dërguar me konstatime, dhe atë:

- Kërkesa e MAPL për rishqyrtimin e Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës, e cila është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur më 28.05.2025.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:

18 prill 2025 e vazhduar më 28 maj 2025; 28 maj 2025; 19 qershor 2025; 26 qershor 2025.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë kemi 4 procesverbale nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit që kemi paraparë, mirëpo procesverbali nga mbledhja Solemne për Ditën e Çlirimit më 19 maj 2025 nuk ka mund të përgatitet me kohë për shkak se i njëjti duhet të përkthehet edhe në gjuhën angleze për arsye se siç e dini në atë mbledhje kanë qenë prezent dhe kanë marrë fjalën edhe përfaqësues nga IOWA - SHBA dhe është nënshkruar edhe një Marrëveshje, andaj në ndër kohë do t'ju dërgohet edhe ai procesverbal posa të jetë i gatshëm.

Prandaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth procesverbaleve sipas kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë i vë në votim sipas radhës këto procesverbale ashtu siç ju janë dërguar me thirrje e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë për momentin, miratohen pa vërejtje apo plotësim ndryshime, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe atë:

-Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 18.04.2025 e vazhduar më 28.05.2025

-Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 28.05.2025

-Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 26.06.2025

Ndërsa Procesverbali nga mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 19 qershor 2025 për Ditën e Çlirimit të Podujevës, mbetet që të procedohet në mbledhjen e radhës, kjo për shkak se është në proces të përkthimit në gjuhën Angleze.

2. Raport i Monitorimit të Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (periudha e raportuar janar - qershor 2025) dhe Rekomandimet

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij Raporti, theksoi, në këtë seancë po e paraqes Raportin e monitorimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim për periudhën janar-qershor 2025, Raport i cili është përgatitur duke u bazuar në nenin 22 pika 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Përmbledhje ekzekutivi; numri total i kontratave që janë aktive është 19, sipërfaqja totale e dhënë në shfrytëzim është 10906.95 m² ku përfshihen sipërfaqet tokësore dhe lokalet afariste, qëllimi i shfrytëzimit është afarizëm.

Përmbledhja e përgjithshme; në DPKGJ, në janarin e vitit 20256 kanë qenë aktive gjithsej 131 kontrata për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, shumica e këtyre kontratave 111 të tilla lidhen me shfrytëzimin e hapësirave të veprimtarive afariste kryesisht për lokale tregtare dhe për tezga të vendosura në tregun e qytetit.

Për shkak të implementimit të projektit për banimin e përballueshëm dhe social, të gjitha këto kontrata janë shkëputur bazuar në nenin 5 të kushteve kontraktuale dhe shkëputja e tyre është realizuar nga ana e Komunës në përputhje me nevojat e planifikimit urban. Disa prej tyre kanë qenë pagues të rregullt ndërsa disa prej tyre kanë pasë obligime të bartura.

Gjithashtu një kontratë për shfrytëzimin e parcelës në fshatin Sallabajë ka skaduar dhe nuk është vazhduar. Sa i përket kontratës me Shoqatën e Gjahtarëve “Llapi” e njëjta është shkëputur dhe është në procedurë gjyqësore.

Pra momentalisht kontrata aktive janë 19 ku përfshihen edhe disa lokale afariste që gjenden në rr."Skënderbeu" si dhe disa njësi kadastrale.

Sa i përket përmbushjes së obligimeve financiare, në bazë të Raportit të DPKGJ, një pjesë e qiramarrësve janë të rregullt në pagesa ndërsa të tjerët kanë detyrime të prapambetura dhe borxhe të bartura nga vitet paraprake, pra prej tyre 8 janë pagues të rregullt, 6 paguajnë por jo rregullisht, ndërsa 5 prej tyre kanë obligime të papaguara dhe të bartura nga vitet tjera e që të gjithë janë njoftuar për obligimet e papaguara që kanë dhe për pasojat që bartin nga ato obligime.

Në bazë të këtij Raporti të DPKGJ që i është bërë Kryetarit të Komunës, në sektorin e pronës janë iniciuar gjithsejtë 4 procedura të shpronësimit, 3 prej tyre kanë të bëjnë për pronat nën menaxhimin e AKP-së e që këto procedura zhvillohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa 1 prej tyre është për prona private që Komuna është duke i zhvilluar procedurat e shpronësimit. Po ashtu është përfunduar edhe një lëndë që ka të bëjë me këmbimin e pronës dhe është lidhë kontrata për këmbimin e pronës.

z.Haki Rudari, theksoi, para vetës në këtë pikë të rendit të ditës kemi një Raport të monitorimit të Kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën kohore janar - qershor 2025, dhe rekomandimet, dhe në këtë Raport ashtu siç e elaboroj edhe drejtoresha parafolëse qëllimi është që t'i kemi të dhënat e detajuara lidhur me implementimin dhe respektimin e kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për këtë periudhë si dhe të identifikoj shkelje, vonesat apo pagesat ose mos pagesat në këtë periudhë kohore.

Të gjitha këto janë të parapara edhe në Ligjin nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Në këtë Raport kemi numrin e kontratave aktive, sipërfaqen dhe qëllimin e që ndër të tjera si qëllim është afarizmi, respektivisht qëllimi i dhënies së këtyre pronave në shfrytëzim ndër të tjera është edhe hapja e vendeve të punës por edhe të hyrat vetanake sado që mund të jetë edhe një shumë ndoshta jo e madhe, mirëpo megjithatë ne Grupi i LVV-së jemi që të jepen sa më shumë të jetë e mundur prona komunale në shfrytëzim në mënyrë që të gjenerohen të hyra në buxhetin e Komunës si dhe të hapen vende të punës varësisht nga gjendja financiare e tyre.

Ajo që dua të the po ashtu në emër të Grupit të LVV-së është se kemi disa pagesa që bëhen jo të rregullta apo pagues jo të rregullt, andaj mendojmë se në këtë duhet të jetë më efikas Ekzekutivi i Komunës apo Drejtoria përkatëse të lidhet me këtë aspekt.

Për fund, dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim ne Grupi i LVV-ës e përkrahim dhe vazhdimisht e kemi përkrahur në të kaluarën për arsye se prona komunale nga banorët dhe qytetarët e ndryshëm në mënyrë që të rriten të hyrat vetanake të Komunës dhe po ashtu edhe të hapen vende të reja të punës sado që mund të jetë edhe një numër ndoshta simbolik.

z.Naim Çunaku, theksoi, po debatojmë për një Raport për të cilin si fillim e përgëzoj që është marrë munda dhe i është paraqitur Kuvendit gjegjësisht e ka përmbush një obligim ligjor dhe sot po trajtojmë Raportin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Po ta marrim dhe ta përpunojmë këtë material që e kemi marrë si material të seancës gjegjësisht këtë raport, që në fillim ku thuhet qëllimi i raportit, dhe po të vazhdosh më tutje e sheh që vetëm qëllimi i raportit nuk është përmbush. Po mundohem të jem më i kjashtë për ju dhe qytetarët e nderuar të Komunës tonë, po citoj, ky raport ka për qëllim të paraqes të dhënat e detajuara mbi implementimin, respektimin të kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës nga shfrytëzuesit si dhe të identifikoj shkeljet, vonesat, pagesat, rekomandimet, përmirësimin e të tjera, dhe për këtë thirrret në nenin 22 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave të Komunës dhe që zotëri Rudari pak më parë para meje e citoj një ligj tjetër, ligj i vjetër që tani nuk është në fuqi.

E nderuar drejtoresh (i drejtohet drejtoreshës së DPKGJ e cila nga vendi foli për ligjin e cekur), me gjithë respektin por unë do të doja që njëherë e mirë të mësohemi me formën e debatit dhe dialogut, e jo kështu nga vendi sepse unë hiç nuk e vëra n faj zotëri Rudarin por vetëm e tregova që ta përmirësojmë atë sepse i'u referua një ligji që nuk është në fuqi, pra me gjithë respektin por fajin e matë dikush tjetër e jo ne, gjithçka çka nuk është në rregull është një lloj fajësie, e ne që jemi prezent këtu ta përmirësojmë andaj qëllimi ishte që të përmirësohet ajo që i'u referua një ligji që nuk është në fuqi.

Devijova paksa nga ajo se çfarë duhet të përmbaj raportin dhe për qëllimin e raportit, dhe në raport duhet të paraqiten një për një pronat komunale të cilat janë të dhëna në shfrytëzim, dhe a e kanë përmbushur synimin gjegjësisht qëllimin për çka janë dhënë në shfrytëzim dhe si është gjendja e tyre sot, sa janë ata operatorë gjegjësisht individ që kanë marrë në shfrytëzim këto prona, a janë duke i'u përmbajtur kushteve kontraktuale të kontratës me të cilën i kanë marrë në shfrytëzim, dhe një raport i tillë kish qenë dashtë t'i specifikoj emër për emër të gjithë ato prona që i kemi të raportuara 131 të tilla, ose me mundësi lehtësimi që nëse janë të përafërta njëra me tjetrën të jenë të specifikuar në grupime, por kështu në raport na flitet për 131 prona ndërsa nga fjala e drejtoreshës së DPKGJ i mori shembull vetëm 3 prona specifike, Sallabajën, Tregun dhe Banimin e përballueshëm tek tregu, ndërsa për 128 të tjera vetëm e kemi si shifër por nuk kemi të paraqitura sa të hyra vetanake gjegjësisht sa të hyra ka inkasuar Komuna prej këtyre pronave që janë dhënë në shfrytëzim, si shfrytëzohen, sa ka arrit që ajo pronë që është dhënë në shfrytëzim ta përmbushë kriterin kryesor që të mos jetë aset i fjetur por ta ruaj edhe vlerën e tregut e edhe të krijoj vende pune dhe të krijoj mirëqenie për qytetarët dhe të krijoj të hyr për Komunën.

I'u referua nenit 22 të Ligjit mbi dhënien në shfrytëzim, e unë meqë ky nen është i shkurtër, para juve po e paraqes dhe vetëm po e bëjmë një krahasim mes asaj që i referohet një ligji dhe sa ka përmbushur nga ligji, e që as për së afërmi ky raport nuk i përmbushë cilësitë dhe kriteret që kish deshtë të paraqiten para një trupi monitorues siç është Kuvendi Komunal, por në fillim e hash dhe po e përmbylli me kaq, është ndoshta hera e parë që kemi një kësi raporti dhe për këtë mund dhe për këtë përmbushje të obligimit ligjor të tyre, ndoshta duhet të përgëzohen sepse as obligimet ligjore më nuk po përmbushen dhe nuk ish deshtë që në një demokraci të lëvdohet dikush që e ka përmbushur obligimin ligjor, por jemi këtu ku jemi në formën e veprimit çfarë jemi, dhe edhe përket e përgëzoj q ka marrë mundin me pru një raport, por gjithë tjetër mund të quhet por raport i mirëfilltë për informim mbi gjendjen e shfrytëzimit të pronave komunale, as për ne anëtarët Kuvendit e as për qytetarët nuk i përmbush kriteret e një raporti.

z.Bashkim Syla, theksoi, në Raportin për i monitorimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave publike është paraqitur dhe vetëm numri total i kontratave ku është paraqitur edhe me shifër që janë 20 të tilla, pasi që në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa drejtoresha e DPKGJ na informoj se 1 kontratë është shkëputur nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe sipërfaqja totale e dhënë në shfrytëzim, si sipërfaqe që ka qenë në shfrytëzim nga Shoqata e Gjuetisë "Llapi" për qëllim të shfrytëzimit si afarizëm, për çka në mbledhjen e KPF-së në pyetjet dhe sqarimet që i kemi parashtruar drejtoresha e DPKGJ na është përgjigjur por që u përgjigje edhe sot këtu.

Sa i përket këtij Raporti pajtohem plotësisht, edhe pse po duhet të them se e vlerësoj që e ka sjellë këtë raport sepse unë jam qe 8 vite asambleistë dhe asnjëherë nuk ka pasë një raport rreth kontratave për pronat me qira, mirëpo janë disa mangësi të cilat i ceku edhe kolegu parafolës z.Naim Çunaku sepse është dashtë të ceken pronat më specifikisht, do të thotë ka mundur që në formë të ndryshme të përpilohet një tabelë ku do të specifikohet se cila pronë është e dhënë me

qira, sa është pagesa dhe të tjera, edhe pse te qëllimi në raport ceket numri i pronave për të cilat pagesat bëhen rregullisht, mirëpo si raport ka mangësi dhe ka mundur të jetë më mirë.

Pavarësisht këtyre, e vlerësoj që është sjellë një raport i tillë në Kuvendin Komunal.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe pse parafolësit e përgëzuan drejtoreshën e DPKGJ për sjelljen e këtij raporti, ky veç raport nuk është. Unë edhe dje në mbledhjen e KPF-ës e thash që ky raport me 1 faqe nuk sqaron bash asgjë.

Duke i'u referuar Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Komunës, dhe nenit 22 që i janë referuar, unë po e lexoj një pikë se çfarë duhet të ketë raporti dhe çfarë obligimi jep, rneni 22 pika 2 2 ligjit thotë se, Kryetari i Komunës obligohet që në raportin e tij të rregullt gjashtëmujor t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitoronim e realizmit të kontratave dhe përmbushjen e qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim, kurse në këtë raport edhe pse drejtoresha e DPKGJ e tha që 19 kontrata janë aktive në dokumente e kemi numrin 20, si dhe nuk tregoj përse është shkëputur kontrata, kush e shkëputi atë dhe arsyen e shkëputjes së kontratës me Shoqatën e Gjuetisë "Llapi". Pastaj sa unë kuptova këtu në raport nuk është përendur as se çka ka përfutuar Komuna, sa të hyra ka pasë prej këtyre kontratave, mandej nuk ceken cilat prona kanë kontrata dhe të kenë me lanë dhe të kompletuara e që duhet të jenë, mirëpo raporti është i mangët dhe atë me vetëm 1 faqe raport, andaj mendoj se kjo është vetëm sa për të thënë që e përmbushëm një pikë dhe raportuam ngase ky raport nuk është.

z.Arjant Topanica, theksoi, dua të ndërlihem edhe unë te ky raport dhe duke pasë parasysh secili raport në vete duhet të përmbajë kronologjikisht qëllime në bazë të të cilit pretendohet të arrihet qëllimi i një kontrate të caktuar dhe në fund realizimi apo realizueshmëria e saj, te ky raport në fjalinë e parë thuhet Raport i Detajuar, kurse nëse veç e bëjmë scroll (rrrotullojmë) 3 faqe më poshtë ai përfundon, andaj nuk e di çfarë raporti i detajuar mund të jetë ai i kontratave për dhënien e pronave në shfrytëzim e t'i ketë 3 faqe në tërësi (edhe pse parafolësi z.Ekrem Rrahmani e tha 1 faqe raport), dhe tani si i tillë raporti duhet të përmbajë detaje për të gjitha pronat publike që janë dhënë në shfrytëzim, qëllimin e dhënies së atyre pronave, monitorimin se si është duke bërë ajo, si dhe të hyrat që përfiton Komuna nga ato prona, dhe kur e shohim këtë se çfarë duhet të përmbajë një raport bazuar edhe në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe bazuar në këtë raporte nëse e përdorjmë del që të jetë vetëm përmbushje e një pike të rendit të ditës që për të thënë pastaj se pas një kohe të gjatë, ose të thuhet që më herët nuk është raportuar dhe tani po fillojmë me raportime të tilla për arsye se kanë qenë edhe shumë gjashtëmujore të tjera dhe asnjëherë nuk është raportuar, por ky është gjashtëmujori i fundit edhe jemi në prag të fushatës zgjedhore andaj po mendoj se për atë arsye është bërë dhe që në një formë që të shpërndahet barra dhe të raportohet para Kuvendi dhe para qytetarëve se qysh po funksionon dhënia e pronave në shfrytëzim, pra për keq menaxhimin e tyre që është bërë të shpërndahet një farë faji ku thuhet se kemi raportuar edhe para Kuvendit, andaj mendoj se kjo është arsyeja, e jo arsyeja e duhur për t'u fshehur pas këtij raporti jo të plotë, jo të sakt, të mangët, pa detaje të caktuara e që nuk mund të jetë një raport i mirëfilltë dhe nuk mund të vlerësohet si i tillë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, këtu po shohë që vie në pikëpyetje se a është raport apo jo, mirëpo këtu e ka raport dhe në aspektin gjuhësorë konsiderohet si i tillë. Ka informacione precize konkrete dhe ndoshta do të duhej të ishte mirë të cekeshin edhe të hyrat e Komunës nga dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave Komunale, por megjithatë të hyrat e detajuara nga dhënia e pronave komunale në shfrytëzim, jepet për çdo vit nga zyrtarët përkatës në raportin vjetor financiar komunal.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, vetëm një sqarim dua të bëjë se nuk ka të bëjë fushatë zgjedhore mirëpo ka të bëjë me shkëputjen e kontratave dhe qëllimi kryesor është shkëputja e kontratave që është obligim ligjor dhe çdo veprim që ndërmerret qoftë me lidhje të kontratës qoftë me shkëputje të kontratës është obligim ligjor i Kryetarit të Komunës të raportoj në Kuvendin e Komunës, andaj në këtë aspekt është bërë ky raport për qëllimin sepse janë shkëputur 110 kontrata që kemi të bëjmë me lokalet e tregut, mirëpo janë përfshirë në raport edhe kontratat që janë aktive si dhe për ato të cilat janë aktive por që janë bërë njoftimet për borxhet dhe për shkëputjet e tyre që i presin si dhe zhvillimin e procedurave ligjore.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta kanë pasë probleme për shkëputjen e kontratave në tregun e qytetit ku ka qenë, apo për tezgat e përkohshme që kanë qenë, mirëpo qëllimi i raportit nuk është veç që këtyre i'u është dashtë të raportojnë për ato kontrata të shkëputura sepse ligji e thotë shumë qartë se Kryetari i Komunës duhet të raportoj edhe për kontratat që janë aktive, për të hyrat nga ato kontrata, për shkëputje të kontratave, por nëse i'u ka dal problem juve me kontratat këtu afër ku janë filluar ndërtimet të cilëve ju janë shkëputur dhe nuk i keni sjellë në Kuvendin e Komunës dhe nuk na keni pyetur neve fare që duhet t'i shkëputim sepse më herët para rreth 1 ose 2 viteve ne e kemi marrë një vendim për t'jua shlyer borxhet atyre personave në atë hapësirë ku ka qenë tregu (lokale dhe tezgat) ajo është çështje tjetër, mirëpo raporti ka qëllime edhe të tjera e jo vetëm për ato shkëputje të kontratave.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth këtij raporti, nëse jo atëherë raportet e tilla nuk votohen, andaj e konstatojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe vazhdojmë sipas rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti "Furnizim me Mëshqerra"

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, në fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, propozoj që të votohet shtimi i buxhetit dhe kodi i ri për projektin për furnizim me Mëshqerra.

z.Naim Çunaku, theksoi, tani kur kemi para vetës një vendimmarrje për votimin e kodeve shtesë, apo të bëhemi më i kjashtë për qytetarët, për participimin e qytetarëve për subvencione komunale që jepen nga Komuna gjegjësisht nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe në KPF dhe sot këtu, sikur dhe, sot dhe nesër e kam thënë dhe në KPF dhe po e përsëris edhe sot këtu Lidhja Demokratike e Kosovës në këtë mandat gjithmonë ka rezervuar të drejtën dhe ta kundërshtoj pjesëmarrjen në këtë masë prej 30% dhe arsyeja pse ka dashtë ta kundërshtoj është se në një formë po mendohet që është një ngarkesë që shumë herë din t'i vë në dilema apo në siklet aplikuesit për të aplikuar për subvencione në Bujqësi, arsyeja është pjesëmarrja e lartë dhe e patëm rastin konkret sikurse që tani e kemi për Mëshqerra e q e morëm shembull që në një periudhë kohore më herët një përfitim i një Mëshqerre ka mbërri shifrën afër 3000€ dhe nëse me 30% një përfitues aplikon për ta marrë një kesi subvencioni i be që duhet të paguaj rreth 1000€, dhe këtu ishte poenta që në një formë e kundërshtuam.

E kemi kundërshtuar edhe kur është miratuar kjo Rregullore në kuptimin kur për herë të parë kur janë bërë bujqit të paguajnë gjegjësisht të participojnë për subvencion, krejt duke menduar që qëllimi i një subvencioni në bujqësi e cekëm edhe dhe në KPF dhe po e përsëritim edhe sot këtu, në vete i ngërthen dy komponentë; 1-që të krijon mirëqenie dhe ekonomi familjare për zhvillimin e tyre gjegjësisht veprimin si operatorë për qëndrueshmëri të ekonomive familjare dhe 2-jop asgjë më pak e rëndësishme të subvencionohet dhe të rritet prodhimi i produkteve bujqësore në Kosovë

me qëllimin që sado pak të ndikojmë në importin sa më pak të produkteve bujqësore, pa hyrë te sigurimet e produkteve bujqësore që ato produkte diçka që të paktën e kanë një siguri të konsumit. Ku na doli telashja, pas këtyre debateve drejtoresha e BPZHR në vend që të jetë ajo që është llogaridhënëse para KPF-së dhe para Kuvendit doli në rolin që të kërkoj llogari se kush e ka bërë rregulloren dhe pse e keni votuar këtë Rregullore, dhe ata që e kanë votuar këtë Rregullore, për njoftimin e gjithë juve dhe për njoftimin e gjithë opinionit publik rreth kësaj teme sepse dje në KPF nuk e pata rastin sepse drejtoresha e DBPZHR pas fjalës së vet e përmbushi synimin e vet dhe e lëshoj seancën dhe nuk deshti përballje, sot po përballemi këtu bashkërisht para juve.

Zonja drejtore e DBPZHR, hiç nuk kam pas qëllim të flasë për emrin e juaj, mbiemrin e juaj, prejardhjen e juaj. Unë këtu nuk kam aspak personale por kam të bëjë që ta kryej misionin tim përfaqësues vendimmarrës, por ju kaluat aq larg sa që dashtë të na shpjegoni edhe se kush i përmbush kriteret e një vepre penale, kush e konsumon një vepër penale dhe aq larg shkua sa që për herë të parë pas gjithë këtyre viteve një drejtor/sh më drejtohet duke më thënë ke bërë vepër penale, pyetja është, cila është arsyeja, çka kam bërë unë vepër penale, por harroj që një prej elementeve të veprës penale kryesore është rrezikshmëria shoqërore dhe unë si përfaqësues i qytetarëve nuk di çfarë rrezikshmërie shoqërore kam bërë kur një përfitues që është shumë e mundshme të ketë keqpërdorur subvencionin e Komunës. Dhe kur filloj (drejtoresha e DBPZHR) të na ligjëroj për procedurat e veprës penale mendova që do të shkoj aq larg që do të na shpjegoj edhe Magna Carta Libertatum për të drejta dhe liritë themelore të sanksionuara prej Kombeve të Bashkuara, dhe harroj që këtu para nesh është veç një drejtoresh e DBPZHR dhe që primare duhet të jetë ta prezantoj atë çfarë është.

Për të mos qenë i tepërt, ndoshta ne të gjithë thirremi këtu në pastërtinë tonë gjegjësisht e mbajmë për pastërti, por ju bëjë thirrje publike kolegë të nderuar, unë tani do ta lexoj vetëm një rast një subvencionim të fundit që është bërë me Mëshqerra, mirëpo për të qenë korrekt me juve, me taksën qytetare dhe me opinionin publik si menaxhohet një taksë qytetare dhe kush përfiton prej subvencioneve kisha bërë lutje që ky Kuvend të formoj një komision miks prej të gjitha grupimeve politike dhe prej Ekzekutivit, dhe të dalim në vendngjarje e të shohim se kush janë përfituesit e këtyre subvencioneve, pa dashtë të përmend emra edhe pse dikush më sugjeron të bëhem edhe hetues por unë hetues nuk jam por jam përfaqësues por jo hetues sepse organet e hetuesisë dhe ndjekjes janë tjera, pra i them drejtoreshës së DBPZHR se vetëm nga fshati prej nga ajo vie herën e fundit që janë ndarë subvencionet më 29.04.2024 në këtë listë vetëm nga fshati Bradash janë 12 përfitues, prej tyre me mbiemrin e drejtoreshës në fjalë e cila na e tregoj dje në KPF thua që ne nuk e kemi ditë, janë 4 përfitues, dhe po të kesh parasysh se sa është madhësia e fshatrave të Komunës së Podujevës 78 fshatra, pjesëtojeni me atë 12-shin se ku ka shkuar ato subvencione.

Nëse dikush mund të ketë dilema në këto që i ceka sa i përket korrektesisë dhe për vërtetësinë e tyre, sërish e lus këtë Kuvend që ta formojmë një komision miks dhe të gjithë subvencionuesit në bujqësi t'i shikojmë se a kemi arritur ne me atë subvencione të ngritim ekonomi familjare, të ngritim mirëqenien, t'i jemi në ndihmë bujkut apo janë përdorur e keqpërdorur e që ndoshta është shumë normale që në një pjesë të madhe të ketë keqpërdorime, mirëpo të thuhet; ti që nuk e ke lajmëruar keqpërdorimin ke bërë vepër penale, kjo vërtetë është absurd i llojit të vet.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së shprehim përkrahjen e plotë për propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kodit të ri, duke vlerësuar rëndësinë e projekti furnizim me Mëshqerra si një hap i qëlluar në mbështetje të bujqve në Komunën tonë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, e vetmja arsye që unë e votoj këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri, është që nëse nuk votohet ky propozim vendim dëmtohen bujqit, ndërsa sa i përket taksës për participim e kam thënë disa herë që edhe unë jam kundër që 30% të participojnë

bujqit, mirëpo ajo çështje rregullohet duke bërë një komision dhe Ekzekutivi i Komunës e ka për detyrë që ta hartoj dhe ndryshoj atë Rregullore. Nuk jam që të hiqet krejt participimi dhe nuk dua të bëhem këtu as për vota e as popullsitë, mirëpo mendoj se participimi 30% është e dëmshme për bujqit, mirëpo në anën tjetër edhe nëse nuk miratohet ky propozim vendim bujqit dëmtohen dhe nuk mund t'i gëzojnë të drejtat qoftë sa i përket aplikimit qoftë përfitimit nga ky projekt.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe në Grupi i LDK-së e përkrahim si shtim të buxhetit dhe kod të ri, edhe pse jemi kundër 30% të participimi, por paksa më bënë përshtypje që drejtoresha e DBPZHR, a nuk ka plan të punës, dhe përse nuk e bënë këtë kod të ri në fillim me plan të punës por vie për çdo vit me propozime të tilla për kod të ri, pra do të thotë punohet pa plan dhe nuk e din që do të vie subvencionimi dhe shpërndaja e tyre. Mendoj se duhet të ketë plan sepse drejtoresha e din që mjetet janë të ndara për subvencione ta bënë kodin me fillim.

Përndryshe jemi për shkakun e bujqve dhe do ta përkrahim këtë propozim vendim.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, falënderoj të gjithë për komentet e dhëna sa i përket pikës që sapo e propozuam, duke dëgjuar kolegun z.Naim Çunaku për një moment mendova që nuk po bisedohet për mua dhe për një moment isha e hamendësuar se a po bisedohet për të njëjtën seancë që isha ehe unë prezent e që për fat të mirë nuk kemi qenë prezent vetëm unë dhe kolegu z.Naim Çunaku mirëpo kanë qenë prezent edhe shumë kolegë të tjerë të cilët marrin pjesë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ajo që unë prezantoj këtu është e vërtetë që unë mbaj rolin e drejtoreshës së DBPZHR dhe këtë post e mbaj me shumë krenari dhe i përkushtohem me përkushtimin më maksimal dhe jam kontributin tim të pasqorë dhe të padiskutueshëm për interesat e Drejtorisë dhe për interesat e fermerëve, e që sigurisht se kur bie fjala për interesat e këtyre të fundit unë do të kundërshtoj secilin nga ju dhe së pari do ta kundërshtoj edhe vetën në momentin që shoh se unë jam duke bërë shkelje ligjore.

Ajo që kolegu z.Naim Çunaku e përmendi tani dhe e ktheu bisedën, nuk ka qenë kjo qëllimi i diskutimit dhe edhe ai vet e di këtë, por përse e bëri në atë formë sërish ai e di vetë këtë dhe cilat janë arsytet e tij, por unë vetëm po i'a them të timen se ajo çka e përmendi lidhur me veprën penale që unë kam përmendur kolegu në fjalë gjatë diskutimit të djeshëm përmendi keqpërdorimet me subvencione, unë e njoftova që ne në kuadër të DBPZHR flas për periudhën që unë jam drejtoresh kemi krijuar planin e monitorimit vjetor të subvencioneve për vitin 2024 dhe sipas këtij plani bëhen monitorime për çdo muaj tek fermerët të cilët kanë qenë përfitues në të gjitha subvencionet që janë ndarë në atë vit, dhe nga këto monitorime të cilat bëhen në çdo muaj ne në rastet kur hasin komisioni se nuk e kanë subvencionin e marrë të gjitha ato raste dërgohen në Gjykatë.

Kolegu z.Naim Çunaku nuk e përmendi këtë në pjesën e tij por ditën e djeshme mirëpo ndër të tjera tha që njohë dhe rreth 50% të subvencioneve janë keqpërdorur dhe e tha që njoh të paktën 5 nga ato raste, atëherë në momentin kur mua më del para një asambleist i Kuvendit të Komunës, një drejtor, një Kryetar Komune apo kushdo tjetër që mban një post publik dhe thotë që, unë di me fakte së paku 5 raste, atëherë jo mua, por duhet t'i thotë vetes a jam edhe unë duke e kryer një veprë penale, a jam edhe unë bashkë kryes, sepse në fund të ditës ju jeni ata që ju kanë votuar qytetarët dhe nëse ju nuk po mbronin interesat e qytetarëve dhe interesat e fermerëve atëherë shtrohet pyetja çfarë po bëjmë ne, nuk është vetëm një drejtor por jemi bashkërisht që po e luajmë rolin. Përndryshe unë po ju sjellë fakte dhe po ju them shiko, ne e kemi bërë komisionin dhe jemi duke monitoruar dhe kemi raste që kemi dërguar në Gjykatë, madje me plotë krenari e them që konsideroj se jam drejtor/sha e parë që e kam marrë këtë veprim, por me përkrahjen e Kryetarit të Komunës çdo herë, prandaj unë e konsideroj me plotë të drejtë atë që e kam thënë dhe sërish i qëndroj prapa që në qoftë se, jo vetëm zotëri Çunaku, por kushdo që të jetë ai ose ajo që del dhe

më thotë se njeh të paktën 5 raste, dhe unë e pyes se a i ka denoncuar ato raste, a e ke njoftuar Drejtorinë e Bujqësisë, a i ke njoftuar organet kompetente, dhe më thuhet që jo, atëherë unë patjetër do të them sërish që t'i je bashkë kryes i veprës penale, kushdo qoftë.

Sa i përket pjesës tjetër që zotëri Naimi e tha që drejtoresha e DBPZHR nuk u përmbajt dhe doli e lëshoj seancën e KPF-së, por nuk e përmendi që ai dhe kolegu i tij z.Ekrem Rrahmani e thanë që unë jam duke fol a prova, por arsyeja që unë u largova nga ajo mbledhje ishte që unë të shkoj në Drejtori të marrë dhe të sjellë provat sepse siç e potencova edhe dje që në këto 2 vite nuk mund të më gjeni një fjalë të vetme që unë e them pa provë, atëherë provat i kam sjellë edhe sot këtu dhe ë qoftë se më lejohet edhe nga ana e Kryesuesit të Kuvendit unë do t'i paraqes, (duke prezantuar dhe treguar të pranishmëve dokumente), theksoi, ky është vendimi me të cilin është ngritur komisioni i cili bënë monitorimin në terren ku janë 3 zyrtar të DBPZHR, këto janë raportet të cilat bëhen për çdo muaj nga vizitat në terren ku shkruhen datat e vizitës, fermerët e vizituar dhe nga një komen për secilin fermer dhe pastaj në fund të raportit i bashkëngjiten fotografi nga vizita e secilit fermer në terren duke shkruar emrin mbiemrin e fermerit e po ashtu edhe emrin e subvencionit që e ka përfituar. Tani po dua t'ju tregoj edhe një rast të muajit qershor, që komisioni nuk ka hasë në ndonjë rast që është bërë keqpërdorim, por di të them në rast të muajit shkurt dhe ky është raporti që është bërë nga muaji shkurt, për të mos e përmendur emrin e fermerit, por po e lexoj fjalinë ku thuhet; pas inspektimit të kryer në Mëshqerrën e përfituar me numër të matrikulës NN, komisioni konstaton se subvencioni nuk ndodhet në stallë dhe se është shitur, duke përmendur edhe arsyet, e pastaj në fund të raportit tregohen edhe fotografitë për secilin, më pastaj për të njëjtin fermer unë këtu e kam me vete dhe po jua tregoj Padinë që e kemi dorëzuar në Gjykatë, pra po flasim për fakte dhe këto janë faktet që po i paraqes para juve. Mandej po ju tregoj edhe procesverbalet që bëhen nga DBPZHR, dhe unë këtu me vete i kam tri raste të cilat ne i kemi përcjellë në Gjykatë për të cilat kemi konstatuar një gjë të tillë

Këto monitorime bëhen në çdo muaj siç e potencova dhe atë në ditët kur ne i kemi paraparë si Drejtori, dhe në rast se ky komision do të hasë në ndonjë rast të tillë më besoni e asnjë lëndë, kush do qoftë ai përfitues me mbiemrin tim ose jo, në qoftë se është shkelës dhe ka keqpërdorur me subvencione ai person do të ballafaqohet me ligjin.

Sa i përket pjesës tjetër që u përmenden po ashtu të vitit të kaluar, shikoni unë e konsideroj se kjo është një gjë jashtëzakonisht e ulët sepse nuk do të thotë se përse unë mbaj mbiemrin Hoti dhe të gjithë fermerët me mbiemrin tim e që ndoshta ndonjë prej tyre as nuk i njoh e ndoshta as nuk më njohin, të paralizohen pse një drejtoresh e Drejtorisë së Bujqësisë e ka mbiemrin e tyre, kurse në anën tjetër mund të jenë fermer shumë të zellshëm, mirëpo sa për informacion zotëri Naimi e që nuk e konsideroj se nuk e këtë informacion, drejtoresha e DBPZHR nuk bënë vlerësimin e aplikuesve për subvencione, por e bënë komisioni përkatës i cili caktohet për atë projekt, mirëpo në qoftë se ndokush mendon që drejtoresha në fjalë ka ndikim në komision apo në ndonjërin nga listat ju lus të prezantoni faktet dhe ballafaqohemi, unë jam e gatshme.

Sa i përket pjesës së participimit të fermerëve unë e përmenda edhe dje në mbledhjen e KPF-së, nuk kam ardhur për të gjykuar dhe nuk kam bërë asnjë gjykim që u tha këtu, unë kam bërë vetëm një pyetje dje në KPF sepse nuk kam qenë pjesë e Komunës kur është miratuar Rregullorja, por vetëm ju kam pyetur se a jeni ju ata që keni votuar për participimin që e kemi sot, kjo ka qenë pyetja e përgjigja ishte se po përveç z.Ekrem Rrahmanit i cili u deklarua se nuk ka qenë pjesë e Kuvendit, rrethanat ndryshojnë mirëpo unë konsideroj se participimi i fermerëve i kontribuon procesit të subvencionimit, kështu që unë mendoj se është më shumë pozitive të lihet kështu participimi i fermerëve, mirëpo a e vlerësojmë edhe ne që duhet të bëhet një zvogëlim i

participimit jemi duke punuar bashkërisht edhe me Kryetarin e Komunës në këtë aspekt, jemi duke analizuar dhe besoj që shpejti do të vijmë me një propozim.

Nuk konsideroj që lash diçka pa e përmendur, kështu që unë jam e hapur sërish dhe sërish po e them që jam për mbrojtjen e interesave të fermerëve dhe në mos askush tjetër fermerët e dinë këtë gjë kështu që unë mbaj respektin më maksimal për punën e fermerëve që e bëjnë dhe i siguroj dhe premtoj që sikur deri më sot unë do të jem në mbrojtje të interesave të tyre dhe do të punojë për interesin e tyre pa asnjë kusht tjetër, e që besoj se e din Ekremi këtë, e ka dëgjuar nga fermerët.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa kujtoj kaq debat i gjatë nuk është zhvilluar as kur është miratuar Rregullorja, e jo për një kod të ri që është propozuar të miratohet. Përndryshe konsideroj se po dalim shumë prej temës, pra po largohemi nga tema se në këtë pikë temë e kemi vetëm votimin ose jo të propozimit për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin në fjalë në mënyrë që bujqit ta bëjnë pagesën e participimit prej 30%.

Pra atëherë kur është miratuar Rregullorja e kemi votuar këtë 30% dhe tani e kemi këtë vlerë të participimit nëpër projekte të ndryshme të subvencionimit, prandaj e them që këto diskutime që po bëhen tani duhet të bëhen kurdo që sjellët ndryshim plotësimi i Rregullores që mund të vije nga ana e Drejtorive përkatëse e që ne sot nuk jemi duke bërë ndryshim plotësim të Rregullores por jemi duke shqyrtuar shtimin e buxhetit dhe kodin e ri, e përkrahim ose jo këtë.

Kështu që ne dolëm nga tema dhe u stërzgjatëm shumë andaj kërkoj të mos kaloj kjo në monotoni, përndryshe nuk jam që t'ia ndali fjalën askujt dhe jam që secili ta shpreh mendimin e vet, por mendimet të shprehën me më pak fjalë dhe më shkurtë e shqip siç është kjo shprehje në popull.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit nëse t'i vërtetë ke dashtë të mos zgjatet ky debat në këtë formë nuk do të duhej t'ia jepje fjalën kështu parafolëses, e them këtë sepse asaj i'a jepe mundësinë të diskutoj gjatë dhe tani nëse ne vetëm ta dëgjojmë fjalën e saj dhe të mos reagojmë dhe përgjigjemi nuk është në rregull.

Po nisem nga fjala e fundit e drejtoreshës parafolëse që tha e keni votuar Rregulloren, ju them që kjo Rregullore për ndarjen e subvencioneve është votuar në muajin prill 2022, janë procesverbalet ku 21 anëtar të Kuvendit kanë votuar Për, kurse ne Grupi i LDK-së nuk kemi votuar, andaj kjo që e them mund të vërtetohet lehtë sepse janë procesverbale dhe nuk mund të themi andej e këndej.

Çështja tjetër që më bërë përshtypje kur drejtoresha parafolëse e tha, u çudita çka foli Naimi, mirëpo unë e them që asnjë fjalë që e tha kolegu z.Naim Çunaku e që nuk është ashtu, nuk e tha, përndryshe ne këtu kemi qenë në këtë sallë 9 perona kemi qenë, dhe nëse drejtoresha e DBPZHR kur e ka lëshuar takimin dhe nuk ka dashtë përballje, por siç e tha kam shkuar të marrë dokumentet, ka mund të na thotë po shkoj po i marrë dokumentet dhe po vie sërish në mbledhje dhe sigurisht do ta prisnim ne, nuk e tha atë por doli jashtë duke e përplasur derën madje.

Po ashtu drejtoresha në fjalë e tha që komisioni e bënë monitorimin, por nëse kjo vërtetë dëshiron që komisioni të bënë monitorimin kolegu zotëri Çunaku e bërë propozimin që ta bëjmë një komision ad-hoc dhe miks dhe t'i shohim subvencionet se ku kanë shkuar e ku jo, mirëpo drejtoresha e qiti në kontekst tjetër duke potencuar se po e bëjmë monitorimin, mirëpo unë e di që ka më pak raste që kur t'i marrin subvencionit i keqpërdorin ato, por komisioni i propozuar do të shikonte edhe nëse i kanë marrë ato subvencione ata që e kanë merituar, këtu është esenca sepse ndoshta e ka përfituar ai që nuk e ka merituar dhe nuk e keqpërdor.

Çështja tjetër që drejtoresha e tha ishte ajo pjesa kur e ceku që krejt çka ka thënë ajo nuk e “luan topi”, jam e drejtë “si qiri”, po shprehem ashtu siç e mora vesh unë ndërmjet rrashtave, veç ajo çka ka thënë ka bërë dhe nuk e la luajtur asnjë vijë, e them se mirë që paska kesi peronash që nuk gabojnë sepse unë personalisht nga mëngjesi deri në mbrëmje 12 gabime i bëjë kah të shkoj, për mbarë nisem mbrapsht del. Mirëpo tani po marr shembull dhe po i'a përmendi drejtoreshës njërën

prej gabimeve, unë personalisht të paktën nëpër video incizime e gjej duke gënjyer 5 herë, së fundi para rreth një viti në fshatin e vet në Bradash një prej qytetarëve e ka pyetur a do të na i paguani dëmet nga vërshimet e përgjigja e drejtoreshës ka qenë që të gjitha punët janë kryer dhe në këtë javë dalin mjetet financiare, e që sa e di unë ato para nuk kanë dalë ende, mirëpo edhe në shumë vende tjera ka raste të tilla që ke deklaruar drejtoresh por nuk dua të hy më shumë kësaj çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sërish bëj thirrje që të mos dilet prej temës sepse nuk është tema as për Rregullore, as për komision, as për bujqësi, andaj të mos e teprojmë më gjatë sepse nuk mund t'i përmendim krejt kush ka marrë grande dhe krejt çka ka thënë drejtoresha.

z.Naim Çunaku, theksoi, po filloj nga ajo se çka i ka paraprirë një kesi debati dje në KPF dhe çka po i paraprinë sot në këtë mbledhje. Deri sa unë kam diskutuar për këtë pik të rendit të ditës drejtoresha në fjalë, unë emrin nuk po i'a përmendi sepse ajo po e përmend vet emrin e saj që është e drejtë e saj dhe tha që ndihem krenare e që mendoj se prap është kategori morale që ajo mund ta cilësoj se është yll, por të tjerët duhet të flasin dhe të japin vlerësimin sepse çdo kush kur këqyrë në pasqyrë pjesa dërmuese na duket vetja se jemi ata që jemi, por ndonjëherë na mashtrojnë edhe pasqyra, mirëpo ku po d të dal, deri sa unë kam diskutuar kjo (drejtoresha DBPZHR) vazhdimisht ka thënë e pasaktë, e pasaktë, e pasaktë, s'është e vërtetë, s'është e vërtetë, s'është e vërtetë, dhe unë kam treguar që në rend të parë nuk është kulturë e debatit të bisedohet me një asambleistë gjegjësisht dikë që do të duhet t'i japësh llogaridhënie, në atë formë, dhe këtu ka filluar ajo.

Unë dëgjova paraprakisht moralizime duke thënë që unë jam kjo, unë jam ajo, vërtetë ashtu është që ti drejtoresh je ajo që je dhe ana private e juaja nuk na intereson, ana profesionale e juaja nuk na intereson, atë e vlerëson Kryetari yt që të ka bërë drejtoresh, por mua më intereson puna e juaj, dhe nga diçka që shumë e potencove drejtoresh duke thënë, Naimi një të pavërtetë shumë të madhe, Naimi ka thënë 50% janë keqpërdoruar, ju them se unë e kam thënë që nga 5 raste që unë kam informacione dhe që i njohë, asnjëri nga ata sot nuk i kanë ato Mëshqerra që i kanë marrë, dhe nisur nga ky fakt më bënë të dyshoj shumë që rastin sakt, por unë nuk jam hetues edhe sot po ta them, por unë e di njeriun, peronin, individin e që nuk dua ta bëjë publik emrin e tij sikurse nuk deshta as ata të fshatit Bradash t'i bëjë publik sepse ata kanë të drejtë të mundohen të përfitojnë në çfarëdo forme që munden e që është kategori e tyre se çfarë duan ta bëjnë, pra njeriu pasi që e ka marrë këtu Mëshqerrën dhe i ka thënë dikush, sakt e di këtë dhe për ata e përmenda, i ka thënë që paratë për me krye participimin i ka marrë diku tjetër, dhe i thotë kur po mi kthen paratë, përgjigja e tij është s po a shes lopën dhe pa e qu fare e ka shitë lopën.

Çështja tjetër, për t'iu ikur këtyre gjërave, poenta ishte që ta zbusim dhe ta heqim kriterin e participimit për t'i mbërri efektet e njëjta por jo për të prodhuar efekte çfarë po synohet të prodhohen me ato, kështu që drejtoresh është e paqëndrueshme ajo që kinse kam thënë 50%, përndryshe e kemi incizimin e asaj mbledhje.

Po ashtu drejtoresh u thirr në një diçka që më bëri të shqetësohem ku e the që nuk ka qenë vetëm Naimi këtu, shqyr Allah, po e përdori këtë fjalë që nuk e kam fare në fjalor, që nuk kam qenë vetëm unë sepse me pas kanë veç unë dhe ti, ku me ditë çka kish dal, por kanë qenë 9 anëtar të KPF-së dhe i lus kolegët si dhe Kryesuesin, për korrektësi, a ka qenë ashtu që ke vepruar, ke vepruar ke fol çka ke fol dhe je quar ke dal jashtë duke e përplas derën, pastaj të ka thënë dikush respektoje procedurën e kthehu dhe ke ardh sërish në mbledhje ku pastaj sërish e ke penguar Kryesuesin, pa elementaren e mbarëvajtjes së një seance .

E përmende prap dhe nuk e di çka po të lidh dhe çka po të shtyn apo ndoshta e ke atë ndër dijen ashtu kur e përmend konsumimin e veprës penale, zonja drejtoresh e DBPZHR, unë në Kuvendin e Komunës së Podujevës, si anëtar i Kuvendit çfarëdo veprimi që bëjë përveç sulmit fizik, kam imunitet dhe nuk bëjë veprë penale, por do të ishte mirë të dalësh prej asaj lartësie ku e mbajmë ne

por të zbresësh poshtë ku jemi ne. Udhërrëfyes e kemi Ligji për vetëqeverisje lokale, nuk e kemi ashtu qysh të thash më parë Magna Carta Libertatum, por kemi nivelin e vetëqeverisje lokale dhe aty neve na përcakton edhe imunitetin edhe detyrën edhe misionin tonë.

Vepër penale zonja drejtoresh mund të kryesh ti që nuk ke përfillë kriteret e publikuara për aplikim dhe për këtë ti e ke të lehtë të thuash gjema atë, por unë kurrë asnjëherë nuk do të them me emër askënd, mirëpo apelova 2-3 herë që kurdo që keni gatishmëri të formojmë komision miks ad-hoc, do ta shohësh. Në kritere ka qenë që duhet të ketë tri lopë, kurse sa përfitues i kanë marrë të parën lopë, këtë e din ti drejtoresh më mirë se unë, e din edhe pse e keni bërë, është edhe e drejtë e juaja ta bëni përderisa nuk asi ndjekës e që kualifikojnë vepër penale.

Unë do të ndihesha jo shumë mirë, nuk do të doja ët jem në lëkurën e drejtoreshës në fjalë kur në incizime publike, publikisht para opinionit të gjerë të Kosovës dhe Llapit thuhet që kompensime e dëmeve nga vërshime të 16 qershorit janë të kryera, kurse nuk janë të kryera as ato të janarit.

Për fund po e përmbylli fjalimin se nuk dua të merrem më me drejtoreshën e DBPZHR, çka duash thuaje, absolut nuk do të merrem, or të lutem s asgjë personale nuk kam me ty, mirëpo bir në rrafshin ku jemi këtu sepse mua dhe ty na ka atakuar ky pozicion, ti je ardh qysh je ardh drejtoresh në këtë Drejtori e unë jam ardh qysh jam ardh me votat e qytetarëve këtu, kjo na ka bërë të njihemi unë dhe ti mes vete, dhe këtu jemi në raport ti drejtoresh llogaridhënëse para neve.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, ka disa seanca që jemi duke e bërë temë çështjen e participimit, unë nuk e di me çfarë matematike është heqja e participimit e përmirëson mirëqenien e bujqve, mendoj se është shumë matematikë e thjesht, po të hiqe ky participim buxheti për subvencione nuk na rritet dhe në qoftë se ne kemi buxhet për 100 fermerë dhe nëse e heqim participimin do të thotë ne nuk marrim më shumë subvencione, do të thotë në vend që të marrim 100 subvencione i marrim 70.

Çka është një çështje tjetër që mendoj e sot do të duhej të ishte temë është rrija e buxhetit për subvencione, do të thotë gjatë kësaj qeverisje subvencione janë rritë shumë herë më shumë se që kanë qenë në ë kaluarën.

Gjithashtu një diçka që u debatua, edhe unë sikurse drejtoresha e DBPZHR njëjtë mendoj se në qoftë se ne e dimë që ndokund është abuzuar me subvencione atëherë janë organet gjegjëse që duhet të lajmërohen rastet. Në të njëjtën kohë e falënderoj drejtoreshën e DBPZHR për punën korrekte që e ka bërë gjatë asaj kohe që ka qenë drejtoresh në atë Drejtori.

z.Ragip Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së, duke u bazuar në argumentet të cilat i potencoj drejtoresha e DBPZHR sa i përket komisionit përzgjedhës dhe komisionit monitorues, jemi kundër themelimit të një komisioni shtesë nga Kuvendi për këtë gjë sepse ekzistojnë komisionet përkatëse të cilat e bëjnë punën e tyre.

Drejtoresha në fjalë argumentoj me fakte ato çështje të cilat po pretendohen dhe si drejtoresh ishte shumë e hapur, komunikatave dhe ofron çdo dokumentacion për secilin prej neve që ka interesim për çështje të caktuar, andaj mendoj që të mos hyjmë në teoritë spekulative por t'i kthehemi realitetit, e nëse i kthehemi realitetit ata që pretendojnë që ka shkelje apo që i është bërë ndokujt e padrejtë të dalin në foltore dhe t'i cekin me emër e mbiemër se u janë bërë ata dhe tek atëherë është detyrë e jona që të shkojmë dhe ta monitorojmë apo edhe ta përcjellim tek organe përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e falënderoj parafolësin, por nuk jemi ne të përmendim emra e mbiemra të askujt këtu sepse kuptojeni një gjë që ekziston edhe privatësia e njerëzve këtu në Kuvend e foltore dhe nuk kemi të drejtë ne t'ju përmendim emrat askujt e as bujqve, aq më shumë t'ia përmendim emrin ndokujt duke e akuzuar ndokënd për keqpërdorim të subvencioneve në këtë rast. Pra meqë sërish drejtoresha e DBPZHR ka kërkuar fjalën, e lus që shkurt me 4-5 fjali ta përmbyllë këtë sepse tashmë e bëmë temë këtë çështje.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, po e ndjej të nevojshme edhe një sqarim për të gjithë qytetarët që po na ndjekin, në veçanti për fermerët dhe po ashtu për ju të nderuar kolegë, posaçërisht juve që keni qenë dje në seancën e KPF-së e që nuk dua t'i kthehem asaj teme sepse sërish po e citoj se i qëndroj shkronjë për shkronje asaj që e potencova paraprakisht dhe përmenda edhe me prova sot atë që e kam komentuar dhe çka ka qenë esenca e saj, por tani jo si një drejtoresh, por si një qytetare e thjeshtë e Komunes së Podujevës më bënë të ndjejë keqardhje kur të gjithë sa jemi këtu e dëgjojmë një gjë që vazhdimisht potencohet prej një asambleisti të Kuvendit që thotë i di 5 raste dhe të cilat nuk i njofton, për besë është për t'u shqetësuar.

Kryesuesi i Kuvendit, ndërhyrë duke i'u drejtuar drejtoreshës parafolëse që ta përfundoj fjalën dhe se nuk ka nevojë t'i përsëritësh gjërat e njëjta disa sa herë.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, vazhdoi, i nderuar Kryesues kërkoj të mos ma ndalësh fjalën derisa ta përfundoj sqarimin dhe përgjigjet, përndryshe edhe për ty pastaj e kam një koment.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish i ndërhyrë drejtoreshës në fjalë duke i thënë që nuk je ti për të na komentuar neve këtu por je për t'u përgjigjur para Kuvendit, pra je duke e zgjatë shumë fjalimin dhe duke i përsëritur gjërat e njëjta disa herë si dhe jashtë temës.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, vazhdoi, si duket Kryesuesi i Kuvendit është ma ndalë fjalën mua he duke i dëgjuar pjesën tjetër, por si do që të jetë meqë kjo nuk është as nivel i imi i diskutimit, vetëm sa për të sqaruar edhe fermerët, unë fjalën time e thash, provat e mia i prezantova, e po ashtu edhe lidhur me përfituesit nga fshati prej nga vije unë janë komisioni që e përmenda të cilët e vlerësojnë dhe nuk bënë vlerësim drejtori apo drejtoresha e që kjo është një gjë shumë ditur, kështu që unë fjalën time e thash, provat janë këto që janë, faktet janë këto që i shikuat. Prandaj edhe njëherë e them që është diçka shumë serioze kur ju e dini që dikush po keq përdor, ju lutem t'i prezantoni ato raste dhe ju lutem t'i denonconi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e nderuar drejtoresh e DBPZHR, së pari je duke bërë ftesë gabim sepse nuk jemi ne për të denoncuar dikë, të treguam edhe më parë dhe po ta përsërisë për herë të fundit, nuk jemi ne për të denoncuar dhe për hulumtuar, por ne jemi për t'i paraqitur problemet.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk e pata ndërmend të përmend por ne e dim që para një kohe e kemi formuar një komision ad-hoc këtu në Kuvend, dhe ai subvencionim ka dështuar sepse ka gjet shkelje, madje edhe Ministria përkatëse ka gjetë shumë shkelje dhe e ka kthyer mbrapsht ku pastaj është anuluar, pra e dim qysh e kemi mbajtur seancën e Kuvendit dhe çështjet tjera.

Unë më shumë deshta t'i përgjigjem kolegut parafolës z.Ragip Fetahu i cili e tha që nuk ka nevojë për komision, por ai e din që kemi qenë bashkërisht në një komision të tillë dhe kemi kryer një punë të mirë. Por kjo ishte edhe për drejtoreshën e DBPZHR e cila vazhdimisht po thotë se nuk ka pas shkelje, jam ballëhapur e të ngjashme, ne komisioni i mëparshëm i kemi parë ato lista e ato dokumente ku kemi hasë në fotografi të njëjta, pastaj kanë qenë 18 ari kurse i janë shkruar 1.8 hektar, do të thotë i dim ato gjëra dhe nuk është që nuk ka pas shkelje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimi për këtë propozim vendim ka përfunduar dhe nuk kemi arsye më për të zgjatur këtë temën tjetër që u ngrit në kuadër të kësaj pike parafolësi zotëri Rrahmani ishte i fundit që kërkoi fjalën dhe e tha vetëm 2-3 fjali edhe po e përmbyllem këtë pik të rendit të ditës, andaj urdhëroni e vë në votim propozim vendimin sipas kësaj pike ët rendit të ditës dhe materialit përkatës

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 25 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin në sallë, me 23 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri -Projekti "Furnizim me Mëshqerra", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me makineri prodhuese për biznese

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, propozoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës të gjej mbështetjen e juaj.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, fillimisht kërkoj nga ti Kryesues i Kuvendit që të jesh i drejtë me të gjithë sa i përket dhënies së fjalës sepse nuk është normale që një asambleist apo një drejtor/esh ta ketë fjalën më shumë se 5 herë ndërsa disa të tjerëve të mos i'u jepet fjala asnjëherë si ndodhi paraprakisht në pikë e kaluar.

Sa i përket kësaj ike të rendit të ditës ashtu sikurse që e potencova edhe dje në KPF ne Grupi i LDK-së jemi Për dhe e mbështesim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin furnizim me makineri prodhuese për biznese, edhe pse po e kuptojmë se fushata ka nisë pak më herët se që është afati ligjor. Pra e përkrahim këtë propozim vendim, mirëpo edhe në këtë sikurse te pika paraprake jemi kundër participimit.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin furnizim me makineri prodhuese për biznese.

z.Burim Hasani, theksoi, në emër të Grupit të AAK-së edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim i cili ka të bëjë me shtimin e buxhetit dhe kodit të ri për realizmin e projektit për furnizim me makineri prodhuese për biznese.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni ndokush tjetër dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me makineri prodhuese për biznese, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:

5.1. Vendimi nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)

5.2. Vendimi nr.prot.01-463/06-0029237/25 i datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)

5.3. Vendimi nr.prot.01-020/04-0029236/25 i datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)

5.4. Rregullorja nr.prot.01-016/01-0029232/25 e datës 28.05.2025 (Shkresa e MAPL-së)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me një kërkesë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL që ka të bëjë me rishqyrtimin e një vendimi që e kemi marrë në këtë Kuvend, e që ndërlidhen mes vete 3 vendime, pra siç e keni parë në material kemi një shkresat e MAPL-së për rishqyrtimin e 3 vendimeve të Kuvendit të cilat janë miratuar në mbledhjen e datës 28 maj 2025.

Realisht nëse e analizojmë këtë del që vendimi fillestar me të cilin kemi ndërhyrë në Listën e veçantë të pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025 ku për pronat përkatëse në Zonën Kadastrale Lupç që ka qenë afatshkurtër është menduar që të ndryshohet ajo periudhë kohore në afatgjatë, kjo për arsye kryesore për arsye se ne kemi ndërhyrë për ta ndryshuar dhe qëllimi jonë ka qenë dhënia në shfrytëzim afatgjatë të asaj prone për arsye se për atë pronë janë

interesuar shumë biznese për ta marrë atë ponë në shfrytëzim andaj kjo ka qanë arsyeja që të jepet në shfrytëzim për një periudhë afatgjate.

Pra qëllimi ka qenë krejt për interes publik, investime dhe zhvillim, mirëpo MAPL ka vlerësuar në një mënyrë, siç i keni parë në Shkresa, se në këtë fazë pra gjatë vitit nuk mund të ndryshohet kështu q[edhe ne si Kuvend e kemi ditë pak a shumë këtë çështje, ka pasë edhe në atë mbledhje debate ku është thënë se nuk mund të ndryshohet mirëpo qëllimi jonë ka qenë i mirë dhe këtë e dimë ët gjithë që ajo pronë të jepet ë shfrytëzim për një periudhë afatgjate dhe të shfrytëzohet, por që kjo nuk ka kaluar në MAPL e cila ka kërkuar rishqyrtimin e këtij akti e rrjedhimisht edhe 2 vendimeve pasuese që kanë qenë dhe që ndërlidhen me këtë vendim, andaj në këtë aspekt neve na mbetet që t'i anulojmë këto vendime sepse si të tilla nuk mund të kalojnë tutje, aq më shumë tani kur janë shpallur zgjedhjet lokale, pra jeni në dijeni se 6 muaj pas shpalljes së zgjedhjeve lokale nuk mund të jepen prona në shfrytëzim e që kjo ka qenë arsyeja.

Mbetet që Drejtorisë së Pronës gjatë këtij vitit nëse është interes i Komunës ta përfshijë në Listën e veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin e ardhshëm.

Pra këto vendime nuk kanë prodhuar kurrfarë efektesh ligjore, qëllimi ka qenë krejt i mirë që të investohet dhe të ketë punësim mirëpo Ministria nuk ka menduar ashtu dhe këtë kërkesë e ka sjellë që t'i anulojmë vendime ë fjalë, andaj dhe propozoj që të anulohen, por paraprakisht e hapi debatin.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, më shumë e mora fjalën që t'ju tregoj dhe t'jua rikujtoj se në seancën e Kuvendit të datës 28 maj 2025 kolegu z.Naim Çunaku e ka arsyetuar përse nuk bënë të votohet për propozimet në fjalë duke cekur ligjet, nenet përkatëse. Pra ne kemi kërkuar të mos votohen këto propozim vendime sepse ka qenë e votuar Lista e veçantë e pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2025. Këtu e kam me vete edhe procesverbalin e asaj mbledhje se çka ka cituar zotëri Çunaku që do të thotë e ka ditë sakt, mirëpo ne në pamundësi për ta ndalë atë e lëshuam sallën në atë proces.

Tani nuk po di si të veprojmë tutje, por drejtoresha e DPKGJ nuk qenka prezent këtu sepse në atë mbledhje mu pati drejtuar me emër duke më thënë votoje, por që unë i kam treguar arsyet pse nuk e votoj, ndërsa tani nuk e di a mbetet kuorum nëse ne e lëshojmë sallën sërish kur të votohet për anulimin e këtyre vendimeve të paligjshme që i keni votuar.

Më shumë më ka ardhur mërzi prej disa personave që kur ne e kemi lëshuar sallën, ka pasë anëtarë/e të Kuvendit të cilët kanë ardhur edhe prej Prishtinës pas presionit që i'u është bërë për të ardhur dhe për të votuar. Në këtë aspekt unë nuk e di përse anëtarët e Kuvendi nuk e shikojnë materialin se çka po votojnë e çka jo, e që mendoj se nuk ka lidhje kush të thotë voto ose jo, është për të mirë është për të keq, mirëpo mendoj se ne anëtarët e Kuvendit nuk duhet ta shkelim ligjin, madje shefi i këtyre na pati mësuar me një fjalë ku thoshte kush e shkel ligjin kriminel kurse kush e shkel Kushtetutën është super kriminel, andaj nuk e di a vlen ende ajo fjali apo jo.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë jemi në një situatë që sigurisht çdo njëri prej neve po ta pyeste veten a jemi në nivel të detyrës dhe nëse mendon se brenda 2 muajve kthehen 4 vendime nga shqyrtimi i ligjshmërisë, do ta pyesim veten, për dy muaj ky Kuvend ka marrë 4 vendime në kundërshtim me ligjin. Çka është tjetra shumë me rëndësi, kisha dashtë që kur dikush diskuton në foltore, tjetri të mos e dëgjon se qysh t'i përgjigjet por ta dëgjon këtë që e potencoj Kryesuesi i Kuvendi, Ministria kështu e ashu... Të gjitha këto, para se të merret ky vendim, të gjitha vërejtjet e Ministrisë gjegjësisht shkeljet ligjore që i ka potencuar Ministria, i kemi thënë në këtë foltore, por e ka propozuar dikush tjetër, jo Grupi jonë, dhe për këtë duhet të votohet kundër, mirëpo një gjë duhet ta kemi parasysh vendimet e këtij Kuvendi janë vendime edhe të miat qoftë edhe me votë kundër. Nëse dikush brenda 2 muajve Komunës së Podujevës i'a kthen 4 vendime jo të ligjshme

mua më bënë të ndihem keq pavarësisht që nuk i kam votuar, fle për nivelin e Kuvendit të Komunës së Podujevës ku jam edhe unë pjesë, pavarësisht që jemi në role të ndara.

Më bëri të marrë fjalën Kryesuesi i Kuvendit, i nderuari Kryesues kur e shpjegove arsyen përse ne e kemi shkel ligjin e the që ne e kemi pasë qëllimin e mirë, a mundet ndokush të më tregoj mua që kemi qëllim të mirë që me shkel ligjin, a duhet të kuptohet demokracia si diktaturë e ligjit, të përfillen ligjet e jo të shkelen ligjet, dhe shiko çka na del tani, ne kuvendi i Komunës kemi pas qëllim të mirë kurse Qeveria qëllim të keq, por jo sepse Qeveria gjegjësisht MAPL këtë detyrë e ka, ka paraparë akte që e rregullojnë këtë shtet që vendime e kuvendeve, që sigurisht ai që e ka bërë atë ligj e ka ditë që ka kuvend që nuk i lexojnë hiq, që janë këtu makinë votuese, që nuk e matin hiq çka po votojnë dhe votojnë qorrash, kurse neve na kthehen për dy muaj 4 vendime të paligjshme, vërtetë për keqardhje, vërtetë nuk i bëjmë nderë as Komunës tonë me këtë formë të veprimit. Nëse Qeveria e ka pas keq, a votojmë ne tani kundër Qeverisë dhe themi se Qeveria e ka keq, por ata që kanë votuar për këtë vendim thonë se qeveria e ka mirë për me fut në votim.

Nuk deshta ta përsërisë por nuk kam qare pa e përsëritë atë që e potencoj kolegu para folës zotëri Rrahmani, vetëm shkoni pak në retrospektivë dhe shikojeni fjalimin plotë pompozitet që ai që e shkel ligjin është kriminel, por nuk e kam thënë unë këtë, e ne këtu kemi shkelje të ligjit.

Për fund, thërras anëtarët e këtij Kuvendi nga LDK që pasi që me votën ton nuk kemi dashtë të merren akte të kundërligjshme në këtë Kuvend dhe nuk është dëgjuar zëri ynë, ju lëm që ata që e kanë sjellë ta përmirësojnë gabimin e vet, ne nuk jemi pjesë e gabimeve të tyre, ne nuk jemi ata që e shkelim ligjin, kush do le ta shkel e mban përgjegjësinë, por po më dhimbset ajo (drejtoresha e DBPZHR) që i kualifikonte veprat penale, e ti them se shkelja ligjore është vepër penale.

(Nga Grupi i LDK, lëshohet salla përkohësisht, dhe atë deri sa të përfundon kjo pikë e rendit të ditës, (pikat 5.1; 5.2; 5.3), me arsyetimin siç u potencua se ndër të tjera, në mbledhjen kur janë miratuar këto 3 vendime nga Grupi i LDK-së janë paraqitur kundërshtimet tona e që si Grup edhe në atë mbledhje nuk kemi marrë pjesë në votim dhe e kemi lëshuar mbledhjen, të njëjtën po e bëjmë edhe sot kur po anulohen këto vendime)

z.Artrit Mulliqi, theksoi, zotëri Çunaku pak më parë e th që ne si anëtar të Kuvendit kemi imunitet kështu që në qoftë se ne kemi imunitet në votim nuk e di qysh ka mundësi që e pakemi shkel ligjin, edhe në qefte se e kemi shkel ligjin atëherë do të duhej të kishte ndonjë procedurë ndaj neve e që ne nuk jemi në dijeni që ka ndonjë procedurë.

Diçka që ishte interesante është edhe ku zotëri Çunaku e tha në fjalimin e tij se nuk ka Vetëvendosje, e unë zotëri Çunakut i them që me 12 tetor 2025 do ta merre përgjigjen dhe gjithashtu në këtë datë do të pensionohen edhe shumë politikan të të kaluarës sepse edhe ashtu i'u ka ardh mosha.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar për momentin në sallë janë vetëm 15 anëtar/e të Kuvendit, kështu që nuk ka kuorum për të vazhduar tutje, andaj mbledhja ndërpritet përkohësisht, dhe ju informoj se kjo mbledhja vazhdon sot në ora 13:00.

Sipas propozimit të Kryesuesit, seanca ndërpritet përkohësisht dhe Kuvendi shkon në pauzë (ora 11:40), meqë në sallë ishin prezent vetëm 15 anëtar/e të Kuvendit dhe nuk kishte kuorum për të vazhduar. Njëkohësisht Kryesuesi i Kuvendit cakton kohën e vazhdimet të kësaj seance sot nga ora 13:00,

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:25.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi; Donjetë Baliu.

Nga LDK, Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.

Nga PDK, Mimoza Abdullahu, Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Të pavarur, Demokrat Hodolli.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shujab Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.)

Të pranishëm ishin edhe media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

(Në fillimin e vazhdimin të mbledhjes, përkatësisht në këtë pikë të rendit të ditës, pika 5 (për nën-pikat 5.1; 5.2; 5.3) Grupi i LDK, pa filluar vazhdimin e seancës lëshon sallën për kohësisht, sipas asaj që deklaruan para se të shkohej në pauzë)

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin ku prezent në sallë për momentin ishin 18 anëtarë të Kuvendit, si dhe duke rikujtuar të pranishmit pikat të cilat janë në vazhdim, theksoi, kemi mbetur kërkesat e MAPL-së që të anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës datë 28.05.2025 për ndryshimin-plotësimin, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë viti 2025, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836/25 të datës 11.12.2024 sipas Shkresës përkatëse të MAPL. Pra kemi edhe vendimet tjera të cilat ndërlidhen me këtë pikë të rendit të ditës për të cilat Ministria ka kthyer në rishqyrtim, andaj debati ka përfunduar para se të shkojmë në pauzë, kështu që i vë në votim që të anulohen 3 vendimet përkatëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se:

-Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët sa ishin të pranishëm për momentin në sallë, me vendim anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0029235/25 datë 28.05.2025 për ndryshimin-plotësimin, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë viti 2025, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836/25 të datës 11.12.2024, sipas Shkresës përkatëse të MAPL-së.

-Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët sa ishin të pranishëm për momentin në sallë, me vendim anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0029237/25 datë 28.05.2025 për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia kadastrale parcelë:P-71712029-00202-3 në sipërfaqe 13757 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas Shkresës përkatëse të MAPL-së.

-Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët sa ishin të pranishëm për momentin në sallë, me vendim anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0029236/25 datë 28.05.2025 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale parcelë: P-71712029-3, në sipërfaqe 13757 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas Shkresës përkatëse të MAPL-së.

(Pas këtij procesi, Grupi i LDK-së hyjnë në sallë dhe vazhdojnë pjesëmarrjen në mbledhje sipas pikave përkatëse të rendit të ditës)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani kalojmë në nën-pikën 5.4, që edhe këtu kemi të bëjmë me rishqyrtimin e Rregullores për transparencë të Komunës së Podujevës, dhe atë sipas asaj që keni mund ta shihni në shkresën e MAPL-së e cila ka rekomanduar harmonizimin e nenit 47 sipas udhëzimeve përkatëse të MAPL-së.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, jeni gabim sepse Rregullorja për transparencë në mbledhjen e KPF-së ka hyrë si pikë e veçantë e rendit të ditës. Pra edhe njëherë sa për sqarimin e jua i nderuar Kryesues, ky propozim dje në mbledhjen e KPF-së ka hyrë si pikë shtesë dhe është pikë shtesë dhe si pikë trajtohet e veçantë. Nuk mund ta trajtosh barabartë me pikat tjera kur kjo pikë nuk ka qenë pikë e rendit të ditës me materialin që e keni dërguar te asamblistët dhe me materialin që e keni postuar dje në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe kjo pikë është në kuadër të pikës 5 dhe bëhet fjalë vetëm për një përmirësim sa i përket afatit të hyrjes në fuqi që është 15 ditë e duhet të jetë 30 ditë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne e kemi përkrahë këtë pikë të rendit të ditës kur ka qenë si dokument Rregullore për transparencë, andaj për këtë çështje që ka të bëjë harmonizimin e neit përkatës të asaj Rregulloreje ne do të marrim pjesë.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne shprehim keqardhje që duhet në këtë formë t'i intervenojmë për mbarëvajtjen e seancës së Kuvendit, edhe një herë po e përsërisë.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, mbarëvajtjen e mbledhjes po e pengoni ju sepse po e lëshoni sallën duke e lënë pa kuorum, nuk po e pengoj unë.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, i nderuar Kryesues lëri këto diskutime, po e pengoni ju ose ne mbarëvajtjen e Kuvendit. Ne për pikën e rendit të ditës që kishte të bënte me dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, e kemi dhënë mendimin tonë dhe ka ardhë në kundërshtimin e që edhe nuk kemi marrë pjesë në atë votim, dhe detyrimisht ju kemi thënë kurse ju e keni bërë gabimin dhe ju e përmirësoni gabimin sepse ne nuk do të marrim pjesë.

Ndërsa për këtë që kemi tani në diskutim që është Rregullorja për transparencë, ne kemi qenë pjesë edhe e debatit edhe e përkrahjes dhe ka hy si pikë e veçantë në mbledhjen e KPF-së, dhe nuk mund ta trajtosh tash këtë së bashku me të tjerat dhe të vësh fajin duke na thënë, ju po e bëni. Ne e dim çka bëjmë por ju nuk jeni duke e ditë se çka po bëni.

Tani po i kthehem temës, kjo forma që ne e kemi pasë mendimin e mirë që të jetë 15 ditë, jo 30 ditë, a e dinë ti Kryesues çka është afati 15 ditë sepse janë gjëra të përcaktuara në ligj e t'i ka kthyer MAPL-ja, a është jashtë temës kjo. Po citoj vendimin në bazë të cilit kjo të është kthyer dhe nuk mund të më thuash ti kinse unë po dalë jashtë temës kur jam duke folur për temën konkrete.

Kryesuesi i Kuvendit, i ndërhyjnë duke i thënë që unë jua sqarova mjaftë mirë këtë më parë.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, ti e sqarove por je vetëm njëri prej anëtarëve të Kuvendit komunal dhe ti e jep arsyetimin tënd e unë arsyetimin tim, kuptojë këtë gjë.

Për këtë çështje në këtë pikë, decidimisht unë kam diskutuar dhe kam thënë që e përkrahim edhe pse është e vonuar sepse neve nuk na pengon transparenca në këtë Kuvend komunal, përkundrazi

ne na pengon që Komuna jonë nuk ka arritur të jetë në nivel të transparencës dhe të jetë përfituese e grandit të performancës sikurse komunat tjera, kjo ka qenë ajo dhe e kemi parë si të vonuar dhe i kemi bërë vërejtjet tona edhe atëherë edhe tash, nëse dëshiron po e lexoj procesverbalin çka kam fol dhe të njëjtin arsyetim e keni tani prej MAPL-së, si një Rregullore e cila nuk i përmbush kriteret dhe konditat ligjore që të jetësohet si diçka e ligjshme dhe është shumë pak me rëndësi kjo sepse ne nuk kemi bërë kurrfarë gabimi, por kemi bërë afatin 15 ditë e aty duhet të jetë 30 ditë.

Dihet se e kam thënë se në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Statutit, Rregullores, Udhëzimit Administrativ për standardet minimale, Udhëzimit Administrativ për aktet normative të komunës, që kjo rregullore nuk i ka kaluar këto dhe aty shkruan saktë që duhet të jetë 30 ditë, por jo 15 ditë, dhe për ata është kthyer dhe tash të bëhet sikurse nuk ka ndodh asgjë, pra një diçka që tu ka jep vërejtja në këtë foltore dhe prapë ju keni vazhduar me tuajën.

Ne edhe sot jemi për përmirësim sepse jemi për transparencë, jemi për llogaridhënie dhe këtu nuk mund të na thuash se jemi duke abstenuar apo sabotuar këtë pikë të rendit të ditës ngase ne jemi për këtë pikë që të jetësohet sa më parë dhe të ketë transparencë në këtë qeverisje komunale.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër nga anëtarët e Kuvendit dëshiron fjalën rreth kësaj çështje, nëse jo atëherë e vë në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës sipas Shkresës përkatësisht rekomandimit të MAPL-së për harmonizimin e nenit 47, pra të miratohet sërish Rregullorja për Transparencë e Komunës së Podujevës, si procedurë kjo e rishqyrtimit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, në procedurë të rishqyrtimit sipas Shkresës përkatësisht rekomandimit të MAPL-së për harmonizimin e nenit 47, miratohet Rregullorja për Transparencë e Komunës së Podujevës.

6. Të Ndryshme

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, kam një kërkesë, ka të bëjë për shtimin e një aneksi për personat me nevoja të veçanta në Pishinën Gjysmë Olimpikë në Podujevë.

Të nderuar, me rastin e vendosjes së gur themelit të Pishinës Gjysmë Olimpikë në Podujevë një projekt ky i shumëpritur dhe me rëndësi të madhe për komunitetin, propozoj që në kuadër të këtij projekti modern të parashihet edhe një aneks i veçantë për personat me nevoja të veçanta i cili do të ofroj qasje të përshtatur sipas standardeve Evropiane për personat me aftësi të kufizuara, hapësira të përshtatshme për fizioterapi dhe rehabilitim uhor, shërbime nga stafi i trajnuar dhe profesionist të fushës së fizioterapisë si dhe kujdesit shëndetësor, një ambient të qetë dhe të sigurt që krahas rekreacionit do të ofroj edhe mundësi për terapi fizike dhe mirëqenie mendore.

Një aneks i tillë do të ishte një shembull konkret i përfshirjes sociale dhe kujdesit institucional për të gjithë qytetarët pa dallim dhe do ta kthente këtë investim në projekt me vlera të plota njerëzore, sociale dhe shëndetësore, andaj duke e theksuar në vullnetin e mirë të secilit prej nesh dhe përkushtimin tonë ndaj qytetarëve të Podujevës, shpresoj që kjo kërkesë të merret para sysh gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Kam edhe dy pyetje tjera, mirëpo meqë Kryesuesi po thotë që të vepohet sipas Rregullores ku lejohet vetëm dy, atëherë po e paraqes këtë si më të rëndësishmen. Siç e dim infrastruktura rrugore në Komunën tonë dita ditës po merr kahje të duhur, prej të gjitha rrugëve që janë rregulluar dhe janë shtruar në asfalt, një rrugë siç po shihet është harruar apo anashkaluar, fjala është për rrugën siç njihet nga banorët e asaj ane kryesisht ata të fshatit Sfeçël të cilët e kanë frekuentuar si rrugë më të shkurtër nga shumë lokalitete siç janë nga fshatrat Sfeçël, Dumosh, Gërdoc, Kaçibeg e të

tjerë, pra fjala është për rrugën që lidhë fshatrat Sfeçël-Surkish, siç njihet “rruga nga Polonicat apo nga ish Mulliri i Pashës” afër Mullirit aktual “Mullisi”, rrugë kjo e cila ka një gjatësi rreth 2.5 kilometra dhe shkurton distancën rreth 3 kilometra me Podujevën, andaj shtroj pyetjen s a është në projekte kjo rrugë, e nëse nuk është, pse nuk është dhe ku qëndron puna.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po a shfrytëzoj rastin meqë këtu prezent janë Nënkrjetarja e Komunës dhe drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, siç jemi në dijeni në QKMF-në në Podujevë që një kohë aty kanë qëndruar Policia, shtroj pyetje përse tani në Emergjencë nuk ka policë, a është shkëputur kontrata me Policinë apo cila është arsyeja që nuk qëndrojnë më Policia aty, përndryshe kompani të sigurimeve nuk ka, mirëpo në kohëve të fundit rreth 2-3 vite ka qenë një kontratë me Policinë e Kosovës që të bëjë sigurimin e atyre institucioneve sepse i kam parë pagesat që janë bërë nga ana e Komunës, mirëpo tani në muajin e fundit nuk janë, pyes përse nuk janë.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, dua ta di prej kujt mund të marrim ne përgjigje, shembull për mungesë të ujit të pijes, saktësisht kam ankesa nga banorët që jetojnë në rr.”Esat Mekuli” që kanë mungesë të ujit që disa javë në norma ditore jo normale, prej kujt të marrë përgjigje në këtë pyetje. Gjithashtu në rr.”Haxhi Sadriu”, është bërë një prerje e asfaltit para rreth dy jave dhe ende ajo pjesë nuk është rregulluar e cila është shndërruar në një pengesë shumë të madhe për vetura.

z.Arjant Topanica, theksoi, sa i përket kërkesës për “rrugën e Polonicave” e kisha ngritë edhe unë si shqetësim për arsye se të paktën deri më tani tri herë radhazi e kam ngritë këtë shqetësim para drejtorit të Drejtorisë përkatëse dhe asnjëherë nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Si tërësi pjesa e pa shtruar është më pak se 2.5 km dhe është kosto më e lirë për tu kompletuar ajo rrugë që lidhet me fshatrat Surkish dhe Sfeçël, ka kërkesa të vazhdueshme për asfaltimin e kësaj rruge sepse kjo e lehtëson qarkullimin e banorëve të disa fshatrave që lidhen me Podujevën.

Kam edhe shqetësim tjetër por drejtoresha e DBPZHR nuk qenka prezent, ka të bëjë me dëmet në bujqësi, do të doja ta di a ka ndonjë vërdikt përfundimtar sepse tanimë po bëhet viti i dytë dhe duke thënë se kërkesa është miratuar, ato kanë shkuar në gjirrollogaritë e Ministrisë dhe ende nuk është bërë ekzekutimi i tyre, pra a është anuluar krejt ky si vendim apo çfarë është puna e këtyre kompensimeve. Po ashtu dua një përgjigje edhe te pjesa e ndriçimit dhe trotuarit në fshatin Sfeçël, po bëhet viti i tretë dhe tashmë kur thuajse jemi në fushatë kanë filluar t’i vendosin disa drita, por që dy vite rresht nuk ka në buxhet mjete të ndara për ndriçim sikurse që nuk ka asnjë metër asfalt të shtruar për fshatin Sfeçël, prandaj do të doja një përgjigje nga drejtori i Drejtorisë përkatëse për këtë rast, të paktën tani në fushatë le të përfitojnë qytetarët, andaj këta le të bëjnë një hap.

z.Burim Hasani, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DKA-së por ai nuk është prezent, mirëpo unë po e parashtroj si pyetje, fshati Bradash deri më tani i ka pasë dy shkolla, njëra prej tyre është aktive kurse tjetra është duke u ndërtuar, kurse rastin e fundit Drejtoria dhe Komuna janë duke e shfrytëzuar një sistem adoptimin e disa objekteve për t’i bërë si modele të Çerdheve, andaj kisha kërkuar që tani është mundësia që shkolla është duke u ndërtuar dhe është e mundshme të bëhet adoptimi i një pjese të një këndi që të shndërrohet në Çerdhe në fshatin Bradash sepse në bazë të një analize dhe shikimit në bazë të Çerdheve publike dhe Çerdhet lokale nga fshati Bradash janë 47 fëmijë të cilët janë nëpër Çerdhet publike dhe private.

Kur është e mundshme në fshatin Sfeçël dhe fshatrat tjera të ekzistojnë Çerdhe apo kopshte për fëmijë me 40 nxënës, kurse fshati Bradash me 47 fëmijë t’i adaptoj në Çerdhe, t’i shpërndaj në Sfeçël, Podujevë dhe në kopshte private, nuk është fortë e arsyeshme. Prandaj është mundësia që të bëhet adoptimi i një këndi për një Çerdhe në shkollën e re e cila është duke u ndërtuar kur dihet se fshati Bradash bënë pjesë në kuadër të fshatrave më të mëdhenj në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këto pyetje është mirë t'i adresoni në dëgjimet publike të cilat janë duke u mbajtur tashmë sa i përket përfshirjes së kërkesave në buxhetin vjetor, aty është vendi.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë u tërhoqa prej pyetjes shkaku që nuk e pash drejtorin e DSHPMSh, por me ardhjen e tij këtu në sallë prapë po e marrë fjalën dhe po e bëj një pyetje.

Të gjithë jemi dëshmitarë të këtyre ditëve të fundit për shqetësimet dhe gjendjen e rënduar me zjarrvëniet qofshin ato të qëllimshme apo të pa qëllimshme, dhe duke u nisur nga ky fakt besoj që është dashur drejtori në fjalë të paktën të na informoj mbi gjendjen aktuale që e kemi me zjarrin e në veçanti duhet të na informoj për pajisjet e zjarrfikësve me aparaturë të nevojshme.

Besoj që edhe ju sikurse unë keni dëgjuar që për ato 5 vite ata nuk kanë pasë as veshmbathje në kuptimin e furnizimit të ri dhe sigurisht prapë prej tyre kam dëgjuar dhe besoj se jam në vendin kompetent ku duhet të marrë përgjigjen kompetente. Dua ta di a është e vërtetë që makineria e cila përdoret nga shërbimi i zjarrfikësve që edhe gomat e makinave kanë afat të skadimit ku i kanë kaluar gjitha afatet e skadimit ku ato goma janë më të vjetra se 10 vite dhe vërtetë nëse është kështu atëherë është një rrezik potencial edhe për qarkulluesit tjerë derisa bëjnë intervenime në vatrat e zjarrit gjegjësisht në krizat që çdo ditë po na rëndojnë gjithandëj Kosovës e në veçanti ne jemi të thirrur për Komunën tonë dhe po e bëjmë thirrjen për Komunën tonë.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, së pari po më vie mirë që drejtoresha e DKRS-së është prezent këtu sepse zakonisht në pikën Të Ndryshme e gjuajnë bombën dhe ikin, kam pyetje për të, sa ka qenë shuma financiare për panairin që është duke u mbajtur aktualisht në Sheshin e Qytetit.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, edhe një pyetje kam për drejtorin e DSHPMSh-së, prishjet që po ndodhin në rrjetin e ujës-jellës nëpër rrugët e fshatit Sfeçël po kanë pasoja, po hapen gropa për sanimin e avarisë dhe pas kësaj po lihen gropat midis rrugës, pyetja ime është kjo, deri kur më me këto avari, dëme të asfaltit, gropa të mbushura shkel e shko dhe kush duhet sanuar dëmet e lëna ku pastaj po kanë pasoja makinat gjatë udhëtimit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, shumicën gjërave për zjarrfikësit i tha z.Naim Çunaku mirëpo unë paksa u habita me atë shefin e tyre se si ai nuk bën kërkesa kur ai ka dalë atje në mes të zjarreve e thoshte e falënderoj Kryetarin që na e ka sjellë një gotë ujë e një copë bukë, pra në vend që të thotë do me na marrë zjarri e na duhet të marrim masa për t'i fikur ato zjarre, ai e falënderonte Kryetarin për një copë bukë, video të cilën pastaj e kishin shpërndarë nëpër tik-tok e thonin mbaruam prej këtyre servilëve. Mendoj që atij duhet t'i tregohet që është servil, ai duhet t'i paraqes kërkesat për rrobat e punëtorëve, këpucët, duhet të kërkoj ato gomat që i përmendi kolegu e jo të shkoj të thotë Kryetari i mirë e i hijshëm, e dimë a është i mirë a i hijshëm, nuk ka nevojë të na tregoj ai neve.

z.Fatmir Gashi, theksoi, meqenëse të gjithë po e vërejmë që koha që po vie vërtetë do të jetë kohë e përcjellë me emergjenca të shtuara nga fatkeqësitë e shtuara që kanë të bëjnë me ngritjen e temperaturave e kështu me radhë dhe e cila do të shkaktoj edhe telashe të mëdha. Komuna jonë bënë pjesë në grupin e komunave të mëdha qoftë si numrin e banorëve ashtu edhe atë popullsisë, andaj unë mendoj që është shumë e arsyeshme të rishikohet pas zgjedhjeve meqenëse jemi në prag të zgjedhjeve, mundësia që komuna jonë ta zgjeroj Ekzekutivin edhe me një Drejtorin siç është ajo për Shërbime dhe Emergjencja ashtu siç e kanë shumë komuna tjera në nivel vendi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk kam pyetje por kam vetëm falënderime për zjarrfikësit, për punën që kanë bërë në këto ditë me temperatura të larta deri në 40 gradë, i kam takuar në disa raste duke i fikur zjarret por vërtetë ata janë heronjtë e këtyre ditëve dhe i falënderoj publikisht për punën e tyre në këto kushte shumë të vështira atmosferike me temperatura shumë të larta e që ne nuk mund të qëndronim nën hije kurse ata qëndronin pranë zjarrit dhe rrezikonin jetën e tyre si pasoj e pakujdesive tona që dalim e qesim flija nëpër oborre. Pra unë vetëm i falënderoj sepse nuk jam për t'iu bërë pyetje e as ti di punët e tyre sepse ata janë përgjegjës për punët e tyre.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, mendoj se drejtorët Drejtorive e kanë të detyrueshme të qëndrojnë në sallë për t'i dëgjuar pyetjet dhe të përgjigjen njësoj sikurse asamblastët.

znj.Edona Shabani, theksoi, një sqarim i nderuar Kryesues, e para e punës Kuvendi nuk është vetëm i juaji, e them këtë sepse jeni bërë si avokat dhe as ti vet nuk je duke e ditë se çka po thua, janë disa Rregullore që duhet me i thënë, por je duke u bërë sikur me ta lënë Kuvendin me tapi.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësës theksoi, sigurisht ke harruar se pozitën e kam marrë me votë e nuk ma ka falë askush.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, po përgjigjem në ato pyetje të cilat i dëgjova, por edhe në ato që nuk isha prezent nëse ka pasë diçka të rëndësishme.

Sa i përket zjarrfikësve, e dini që në kohët e fundit jemi përballë me një vllug të madh të zjarreve në territorin e Komunës tonë që fatkeqësisht numri i djegieve të pyjeve dhe fushave është bukur i madh. Unë ditën e djeshme paraqita një raport në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, raport në të cilin janë të gjitha detajet për të gjitha aktivitetet dhe gjithë angazhimin edhe të DSHPMSh dhe Drejtorive tjera si dhe zjarrfikësve e që nëse jeni kurioz mund t'ua sjellë atë raport i cili tashmë është publik. Zjarrfikësit ashtu siç tha Kryesuesi meritojnë një falënderim shumë të madh sepse kanë kryer një punë shumë të madhe në këtë kohë që ka qenë aq e vështirë për ta, ndërsa sa i përket pyetjeve që u parashtruan rreth furnizimit të tyre me pajisje si dhe kërkesat e tyre për çka u tha se ai është servil dhe nuk ka bërë kërkesa, unë ju them që ka bërë kërkesa të vazhdueshme, kërkesat i kemi me shkrim por arsyeja pse deri më tani nuk kemi mund t'ju dalim në ndihmë me logjistikë zjarrfikësve këtë e kemi biseduar edhe më parë këtu që është ajo përzierjen e kompetencave mes Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave-AME dhe Komunave, e që vështirëson goxha shumë këtë çështje, mirëpo ne prapë nuk kemi hesht dhe tani kemi marrë kërkesat prej komandantit për mungesë të disa pajisjeve, pra për këtë po ndërlidhi dy pyetjet që ishin nga Ekremit dhe Naimi, pra komplet listën e kërkesës, komplet çka shkruan në kërkesë të komandantit të zjarrfikësve ne e kemi zhvilluar një procedurë të prokurimit për pajisje me gjitha ato që janë cekë në kërkesën e tyre.

Fatkeqësisht kontrata apo projekti ka shkuar në ankesa dhe tash po presim të zgjidhet si problem sepse është në OSHP, e ju e dini që kur një çështje shkon në OSHP ka vonesa të shumta e që fatkeqësisht kjo lëndë është atje edhe pse ka filluar goxha moti kjo procedurë, në fillim të vitit, me qëllim që në këtë kohë të zjarreve zjarrfikësit të jenë sa më shumë të pajisur dhe të kanë mundësi më shumë të luftojnë me zjarret, pra aty ka edhe uniformë të ndryshme nga ajo sportive deri te uniforma profesionale për shuarjen e zjarreve, janë për të gjithë zjarrfikësit, do të thotë është bërë porosia për komplet uniformën që i'u takon atyre, pastaj aty ka edhe goma që jo keq u potencua që gommat janë me afat të skadimit e që në këtë kohë në pamundësi të furnizimit me kontratën që e kemi për furnizim me goma që e kemi në përgjithësi, ajo cilësia e gomës për mjetet e zjarrit nuk ekziston në atë kontratë, prandaj në kontratën e re që është iniciuar e kemi fut edhe pajisjen me goma për të gjitha automjetet e zjarrfikësve, e që sa mbaj mend nga lista janë edhe pajisje tjera aparate për saldim dy lloje, ka gërrshërë hidraulike për prerjen e automjeteve në rastin e fatkeqësive të komunikacionit, ka madje edhe një preparat të ri që ka ardhë tek ne në Kosovë që bëhet përzierja e tij me ujë dhe e ndihmon shuarjen e zjarrit nuk e di si quhet ai preparat por që po përdoret në Kosovë i cili përzihet me ujë dhe ndihmon në fikjen e zjarrit, dhe të gjitha gjërat tjera të kërkuara.

Përveç tjerash, kemi rritë stafin me aq kapacitete dhe mundësi që kemi pasë si komunë, në fakt nuk e kemi rritë stafin ne si komunë por janë shtuar edhe 2 zjarrfikësit të rinj që është bërë rekrutimi nga AME apo MPB dhe tani janë dy zjarrfikës më shumë, por sërish kemi mangësi, kemi pak zjarrfikës, mirëpo aq sa kemi mundësi në bashkëpunim edhe me MPB dhe AME-në po mundohemi që t'i kryejmë obligimet tona që na takojnë si dhe ato që nuk na takojnë si Komunë sepse logjistika

është e AME-së por ne sërish kemi iniciuar vetë ngase u pa që ata nuk kanë mundësi dhe buxhet t'i ofrojnë uniformat dhe pajisjet tjera të ndryshme, prandaj e kemi iniciuar ne si Komunë këtë proces, dhe po presim të lidhet kontrata e t'i furnizojmë zjarrfikësit.

Përndryshe puna e tyre në këtë kohë që ka qenë e vështirë për neve, ka qenë shumë e madhe, është punuar me shumë vullnet, kemi dalë në terren dhe i kemi parë edhe në media e portale siç i ka parë edhe Ekremi në tik-tok, por si do që të jetë kemi dashur të jemi afër tyre me aq mundësi sa kemi pasë që t'i mbështesim, të paktën moralisht t'ju japim mbështetje.

Kemi bërë kërkesë edhe në AME për ndihmë, po ashtu kemi kërkuar mbështetje edhe nga Komuna e Prishtinës e cila na ka dalë në ndihmë në fikjen e zjarreve, mandej kemi bërë kërkesë edhe në FSK për të na ndihmuar për fikjen e zjarreve, me një fjalë është menaxhuar mirë situata me këto kapacitete që i kemi pasë. Fatmirësisht nuk ka dëme materiale në shtëpi apo në njerëz, ka pasë disa lëndime të zjarrfikësve ngase sigurisht kur përballesh me zjarrin mund të kesh edhe lëndime por që non-stop ka qenë e angazhuar ndihma e shpejtë, të cilët e kanë ofruar ndihmën e shpejtë sipas nevojës. Tani së fundi po presim të lidhet ajo kontratë dhe zjarrfikësit të jenë të pajisur.

Sa i përket dëmeve që janë bërë në këtë kohë e që është e rëndësishme ta dini edhe ju, janë bërë dëme bukur shumë në djegien e pyjeve dhe të fushave, ju e dini që fushat djegën pak ndoshta edhe qëllimshëm, zjarr vënia është e qëllimshme për shkak të ashtuquajturës ri-gjenerim i tokave nga ana e bujqve e që në fakt e kjo nuk qëndron, mirëpo ata prapë e bëjnë një gjë të tillë, ndërsa te malet kanë filluar hetimet, konkretisht te pishat në fshatin Kërpimëh e që po të shikosh është e tmerrshme qysh duken ato sot në krahasim siç janë dukur më herët. Pra kanë filluar hetimet nga Policia e Kosovës dhe janë duke u intervistuar dy persona të cilët dyshohet e kanë vë zjarrin dhe është bërë gjithë ai dëm i madh, shifrën e saktë e kam të shkruar në raportin përkatës, mirëpo e mbaj mend që janë mbi 300 ha male të djegura, gjithashtu aty afër kemi të djegura edhe fusha, mirëpo te fushat nuk është aq e rëndësishme sepse zjarr vënia është e qëllimshme për kinse regjenerim, mirëpo shifrat e sakta për të gjitha intervenimet për 6 mujorin i kemi në bazë të raportit që na është bërë prej zjarrfikësve të cilin e kemi paraqitur edhe në KKSBB.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, fillimisht e them se kompetencë e kujt është nuk e di, por dua ta di a ka mundësi të bëhen 5 ose 6 hidrante në pika jashtë Podujeve sepse zjarrfikësit po vonohen deri sa po e marrin ujin, këto hidrantë të bëhen shembull në fshatrat Gllamik, Lluzhan, Kërpimëh, Orllan, pra kjo a është kompetencë e Komunës apo e Ministrisë, dhe a ka mundësi të bëhen këta hidrant se ne e dinë që ka mungesë të punëtorëve dhe mjeteve të punës e edhe ka vonesa deri te mbushja me ujë për çka e përsëris që ka vonesa shumë.

Sa i përket angazhimit të zjarrfikësve ashtu siç e tha Kryesuesi, e vërtetë është që janë angazhuar shumë, por pasi drejtori parafolës përmendi mjetet shpresojmë që sa më shpejtë të realizohet ajo kontratë sepse ata kanë nevojë për ato mjete. Ndoshta edhe kjo puna e hidrantëve do t'i ndihmonte shumë sepse kemi rastin e zjarrit në fshatin Penuhë ku zjarrfikësit janë detyruar prej fshatit Penuhë të vijnë në Podujevë për tu furnizuar me ujë, e po të kishte një hidrant në fshatin Lluzhan ose Gllamnik do ishte më mirë sepse do kishin mundësi të furnizoheshin me ujë në pika më të afërta.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, vazhdoi, të gjitha hidrantët lidhen me rrjet të ujësjellësit dhe se aty duhet të ketë ujë ngase hidranti është harxhon shumë ujë edhe konkretisht kompetenca është e Kompanisë së ujësjellësit, mirëpo nuk do të thotë se ne nuk mund të bëjmë kërkesë për hidrantë, kjo në të ardhmen mund të bëhet edhe pse ne po mendojmë që me rritjen e stafit të zjarrfikësve dhe planifikimet dhe mundësitë që t'i kemi edhe dy nënstacione të zjarrfikësve e jo vetëm këtë që e kemi në Podujevë e që do e lehtësojë shumë qasjen dhe punën e tyre në terren, pra këto pika si ide i kemi dhënë për fshatrat Kërpimëh dhe Lluzhan por nuk do të thotë që tani kjo do të bëhet shpejtë sepse së pari kërkohet staf ngase se me këtë staf që kemi stacion nuk mjafton për atë stacion që

është e lëre më edhe dy nënstacione tjera, mirëpo besojmë që po sa të zgjidhet ky konflikti rreth kompetencë mes AME-së dhe Komunave e që sa jam në dijeni ashtu siç na ka thënë është iniciuar edhe ligji sipas të cilit do të bëhen ndryshimet dhe ne pastaj do t'i kryejmë gjitha përgjegjësitë tona si dhe besojmë që në bazë të territorit që kemi si komunë do të na takojnë edhe dy nënstacione tjera për shkak të numrit të madh të fshatrave dhe territor gjeografik që e kemi.

Sa i përket ujësjellësit që parashtroj pyetje znj. Sebastina Vokrri, është e vërtetë që ka ndërhyrje në disa vende në fshatin Sfeçël nga KRU "Prishtina" me qëllim të rregullimit të rrjetit të ujësjellësit dhe janë bërë disa dëme aty, mirëpo punimet janë ende duke vazhduar dhe ende nuk kanë përfunduar ato punime në mënyrë që pastaj që bëhet mbyllja e atyre gropave, e them këtë sepse kur hapet një gropë nga ujësjellësi realisht nuk mund ta mbyllësh menjëherë sepse investimi i menjëhershëm është i kotë ngase mund të vie menjëherë deri te dëmtimi, prandaj ne po presim të përfundojnë njëherë të gjitha intervenimet që është duke i bërë ujësjellësi dhe sigurisht bashkë me ujësjellësin sipas kontratave që kanë ata, do i kthejnë në gjendje të mëparshme, kurse për të tjerat që mund të jenë jashtë kontratave do të merremi ne si Komunë dhe do i përfundojmë. E dimë që janë disa gropa atje por nuk janë vetëm në fshatin Sfeçël, ka edhe në fshatra tjera.

Sa i përket propozimit për Drejtori shtesë që e ceku me të drejtë z. Fatmir Gashi, ne fillimisht si Drejtori kemi bërë kërkesë për ngritjen e një sektori të veçantë të emergjencave sepse nuk kemi as sektor të emergjencave, por do të shohim ngase shtimi i Drejtorive varet nga Kuvendi, jo vullneti imi dhe askujt, do të thotë ju Kuvendi jeni ata që mund ta bëni një gjë të tillë në të ardhmen, ne si Drejtori çka po mundemi po bëjmë dhe në këtë aspekt kemi kërkuar bërjen e sektorit të veçantë për emergjencë e që jen në dijeni që në kuadër të Drejtorisë ka zyrtar të emergjencave, por nuk ka sektor, nuk ka shef të emergjencave e besoj që kjo punë do të kryhet brenda këtij viti.

znj. Vlora Humolli-Jashanica, drejtoresh e DKRS, theksoi, po i përgjigjem znj. Tringa Sfishta lidhur me pyetjen që e bëri për subvencionimin e panairit arti-zanal që është "Kujtimet nga Atdheu", është financuar në vlerë 4000€ dhe me këtë, panairi nuk përfundon sepse do të jetë edhe në muajin shtator që do të jetë punëtori me gratë e Komunës së Podujevës.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, kërkesën që e pata për shtim të një aneksi për persona me nevoja të veçanta në Pishinën Gjysmë Olimpikë në Podujevë, sa janë mundësitë për tu shtuar ai aneks dhe a duhet të ndahet buxheti prej Ministrisë apo prej Komunës sepse është projekt në bashkëfinancim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar së po e shihni që disa minuta jemi pa kuorum, por meqë ishin në pikën Të Ndryshme dhe nuk ka vendimmarrje apo shqyrtim të projekt akteve, përveç çështjeve të ndryshme që u ngritën me rëndësi siç ishte ajo për zjarret dhe zjarrfikësit, bëmë përjashtim dhe vazhduam me pyetje, përgjigje dhe sqarime të nevojshme.

Prandaj meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e konstatojmë të përfunduar këtë mbledhje.

Nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja ndërpritet në orën 14:15

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr. Prot. 01-060/04-0044929/25

Podujevë,

30 korrik 2025

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha